



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

*Ministria e Ekonomisë dhe Financave - Ministarstvo Privrede i Finansija -
Ministry of Economy and Finance*

UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr.10 / 2010
PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.3/L-146 PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR

Ministria e Ekonomisë dhe Financave

Mbështetur në Nenin 64 të Ligjit Nr.03/L-146
“Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar”, Ministria e Ekonomisë dhe Financave,

nxjerr:

UDHËZIMIN ADMINISTRATIV
PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.03/L-146 PËR TATIMIN MBI VLERËN E
SHTUAR

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurave dhe kërkesave për zbatimin e Ligjit nr 03/L-146, në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Personi cili Kërkohet të Regjistrohet dhe të Përfshihet në Regjistrin e TVSH-së

1. Person i tatueshëm është cilido person fizik ose juridik i cili është i detyruar të regjistrohet për TVSH. Një person është i detyruar për t’u regjistruar për TVSH, kur personi në mënyrë të pavarur kryen aktivitetet ekonomik në mënyrë të rregullt apo të parregullt në Republikën e Kosovës, në pajtim me nenin 4 të Ligjit dhe qarkullimi i të

cilit (duke përfshirë edhe qarkullimin e furnizimeve të liruara të TVSH-së) në tërësi për 12 muajt e kaluar, e tejkalon pragun prej 50.000 euro. Në muajin kur tejkalohej pragu llogaritet për periudhë dymbëdhjetë mujore (12) të llogaritjes.

2. Personi i tatueshëm duhet të ketë numrin fiskal të lëshuar nga ATK, i cili do të paraprijë regjistrimit për TVSH. Aktiviteti ekonomik siç është referuar në paragrafin 1 duhet në veçanti të referohet aktivitetit të vazhdueshëm i cili kryhet me qëllim të kryerjes së furnizimeve për konsideratë, pa marrë parasysh qëllimin ose rezultatin e atij aktiviteti ekonomik. ATK mund t'i kërkojë aplikuesit të dërgojë dëshmi për qëllimet e tij për kryerjen e një aktiviteti ekonomik.

3. Personi i tatueshëm që është i detyruar të regjistrohet por që ende nuk është regjistruar për TVSH duhet të dërgojë aplikacionin për regjistrim në Zyrën e Shërbimeve për Tatimpagues në Regjionin përkatës, brenda 15 ditëve kalendarike pasi që të konsiderohet të jetë person i tatueshëm.

4. Pragu i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk vlen për personat që nuk janë të themeluar në Kosovë. Personat e tillë janë të detyruar të regjistrohen për TVSH në Kosovë në qofte se ata kryejnë furnizime në Kosovë dhe duhet të emërojnë një përfaqësues tatimor. Personi i tatueshëm duhet të regjistrohet në emrin e tij dhe në emrin e përfaqësuesit tatimor përpara se të kryej ndonjë furnizim duke e pasur vendin e furnizimit në Kosovë.

5. Kur zbatohet procedura e ngarkesës së kundër siç referohet në nën-paragrafin 1.2, 1.3 dhe 1.4 të nenit 52 të Ligjit aty është se pranuesi është i detyruar të paguajë TVSH-në, furnizuesi nuk është i detyruar të regjistrohet për TVSH në Kosovë ose të emëroj një përfaqësues tatimor siç përmendet në Paragrafin 4 i nenit të udhëzimit..

Neni 3 Kalimi i Pragut të Shikuarit së Prapthi (Retrospektiv)

1. Me rastin e përlllogaritjes së pragut, personi duhet të marrë parasysh shumën totale të të gjitha furnizimeve të tija përgjatë periudhës së 12 muajve të fundit. Furnizime quhen furnizimi i çfarëdo malli dhe shërbimeve me çfarëdo norme, duke përfshirë edhe ato të liruara me të drejtë kreditimi dhe pa të drejtë kreditimi. Personi konsiderohet person i tatueshëm nga momenti kur shuma e gjithëmbarshme e furnizimeve që ai ka kryer brenda 12 muajve të fundit e tejkalon pragun e regjistrimit të paraparë me nenin 6, paragrafi 1 i Ligjit.

Shembull:

Tatimpaguesi ka kryer këto furnizime gjatë periudhave si më poshtë

Periudha		Qarkullimi	Qarkullimi total
Dhjetor	2009	7000	7000
Janar	2010	10000	17000
Shkurt	2010	10000	27000
Mars	2010	1000	28000
Prill	2010	5000	33000
Maj	2010	5000	38000
Qer.	2010	1000	39000
Korrik	2010	1000	40000
Gusht	2010	2000	42000
Shtator	2010	2000	44000
Tetor	2010	3000	47000
Nëntor	2010	4000	51000
Dhjetor	2010	8000	59000

2. Në rastin e mësipërm, pragu për regjistrim do të tejkalohet në nëntor të 2010-ës sepse në nëntor të 2010-ës e tejkalon qarkullimi prej 50 000 eurove. Për çdo furnizim të bërë nga personi i tatueshëm pas kalimit të pragut do t'i nënshtrohet TVSH-së. Në këtë rast, personi i tatueshëm duhet të aplikojë për regjistrim për TVSH brenda 15 dite pas tejkalimit të pragut.

3. Që nga data kur Ligji ka hyrë në fuqi, kalkulimi i pragut do të bazohet në periudhën e 12 muajve të fundit siç është paraparë në nenin 6 paragrafi 1 i ligjit, e jo me vit kalendarik siç ka qenë në ligjin e mëhershëm të TVSH-së. Nëse qarkullimi i një personi i tatueshëm, në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit, do të ketë furnizime më të larta se 50 000 euro (brenda periudhës së fundit 12 mujore), do të konsiderohet personi i tatueshëm që nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit.

4. Sipas nenit 6 paragrafi 1 i Ligjit, nëse një person në 12 muajt e fundit ka pas qarkullim 49 000 euro dhe njëherit ka kryer furnizimin e fundit në vlerë prej 3 000 euro, pjesa e tatueshme e furnizimit të fundit do të jetë vetëm vlera që ka tejkaluar furnizimet e përgjithshme prej 50 000 euro që në këtë rast është shuma 2 000 euro.

5. Siç është paraparë me nenin 6 paragrafi 5 i Ligjit, personat jo rezident të cilët do të zhvillojnë aktivitete ekonomike në Kosovë, nuk i nënshtrohen rregullave dhe procedurave që kanë të bëjnë me pragun për regjistrim në TVSH, por do të konsiderohen si persona të tatueshëm që nga momenti i fillimit të aktivitetit të tij ekonomik në Kosovë dhe janë të obliguar të regjistrohen me një përfaqësues tatimor përpara se t'i kryejnë furnizimet në Kosovë, përveç rasteve kur pranuesi është i detyruar të paguajë TVSH-në mbi furnizimet në pajtim me nënparagrafët 1.2, 1.3, 1.4 të nenit 52 të Ligjit.

Neni 4 Deklaruesi Vullnetar

1. Çdo person që i plotëson kushtet e referuara në nenin 4 të këtij Ligji, por që nuk i plotësojnë kërkesat për regjistrim të referuara në nenin 6 të këtij ligji, e ka të drejtën

që të zgjedh për tu regjistruar në TVSH si person i tatueshëm. Ai duhet që të dorëzojë kërkesë në Shërbimin e Tatimpaguesve në zyrën regjionale përkatëse, për regjistrim vullnetar.

2. ATK duhet të regjistroj personin e tillë me efekt nga data e pranimit të kërkesës në Zyrën e Shërbimit të Tatimpaguesve, nëse personi që bën kërkesën plotëson kushtet e nenit 4 të këtij ligji

3. Tatimpaguesit e regjistruar vullnetarisht i nënshtrohet rregullave të njëjta në lidhje me ndryshimin dhe pushimin e aktivitetit sikurse personat e tatueshëm të regjistruar në pajtueshmëri me nenin 6 të këtij Ligji.

Shembull:

Nëse një tatimpagues regjistrohet si deklarues vullnetar për TVSh ,meqenëse qarkullimi i ti është me i vogël se pragu 50.000€ gjithsesi duhet të deklarojë deklaratën mujore nga periudha kur është regjistruar si deklarues vullnetare, pra tatimpaguesi duhet të deklarojë dhe të paguaj TVSh-në për çdo furnizim të kryer nga ai, pas datës së regjistrimit.

4. Çdo person i tatueshëm nëse nuk ka furnizime apo blerje brenda një periudhe , tatimpaguesi duhet të deklarojë deklaratën e tij me zero, për të treguar se ky tatimpagues është aktive, por nuk ka aktivitet për atë periudhe.

5. *Qarkullimi që duhet të përfshihet në prag.* Kur përcaktohet se a është tejkaluar pragu i 50,000 apo jo, qarkullimi i të gjitha aktiviteteve i të gjithë personave, ushtruar në të njëjtin vend apo në një vend tjetër ose që është kryer në të njëjtën linjë të biznesit ose në linjë tjetër të biznesit, duhet të merret parasysh. Kjo vlen si për personat fizik po ashtu edhe për ata juridik.

Neni 5

Regjistrimi i Personave në TVSH nga ATK, kur Personi nuk bën Kërkesë për Regjistrim

1. Çdo person i cili ka plotësuar kriteret e nenit 6 të ligjit, dhe nuk është regjistruar për TVSH, do të regjistrohet në mënyrë të detyrueshme nga ATK me efekt retroaktiv nga data kur regjistrimi i tillë është kërkuar siç është përcaktuar në nenin 7 të Ligjit, dhe ATK-ja do të lëshoj Certifikatën e Regjistrimit për TVSH.

Nëse ATK-ja e zbulon më vonë se personi i tatueshëm është dashur të regjistrohet me një datë të mëparshme, ai duhet të paguaj TVSH-në për furnizimet që ai i ka bërë nga data e mëparshme.

Neni 6

Certifikata për Regjistrim në TVSH

1. Personi i cili bën kërkesë për regjistrim, në TVSH, të gjithë formularët e regjistrimit në TVSH duhet ti dorëzojë personalisht apo përmes personit të autorizuar të biznesit në zyrën përkatëse regjionale të ATK-së. Formularët e regjistrimit në

TVSH duhet të shoqërohen me një kopje të dokumenteve për regjistrim të biznesit, Certifikatën e Numrit Fiskal dhe identifikimin zyrtar me fotografi (pasaportë, kartë identiteti, etj.)

2. Me marrjen e formularit për Regjistrim në TVSH, ATK do të sigurojë se informatat në formularin e regjistrimit janë të sakta dhe se tatimpaguesi ka kryer të gjitha detyrimet tatimore. Përveç kësaj, ATK do të vizitojë secilën vendndodhje të biznesit që tatimpaguesi e ka vënë në listën e formularit të regjistrimit për të siguruar se është dhënë saktësia e të dhënave. ATK do të përcaktojë se a të lëshoj certifikatë të TVSH-së, apo jo, brenda 10 ditëve të punës pas marrjes së Formularit për Regjistrim në TVSH.

3. Nëse ATK përcakton se personi ka të drejtë për certifikatë të TVSH-së, do të njoftojë personin për atë përcaktim jo më larg se ditën e ardhshme të punës pas bërjes së përcaktimit. Personit do t'i jepet mundësia të vizitojë zyrën e shërbimit për ta tërhequr certifikatën e TVSH-së.

4. Secila certifikatë e TVSH-së do të ketë një numër serik unik në faqen e vet. Ai numër serik, i cili është numri i regjistrimit të tatimpaguesit për TVSH, duhet të përfshihet, së bashku me numrin fiskal të tatimpaguesit, në të gjitha faturat e lëshuara nga tatimpaguesi.

5. Nëse ATK zbulon se tatimpaguesi nuk është i rregullt në të gjitha obligimet tatimore apo se informatat në formularin e regjistrimit nuk janë të sakta, ATK do t'i dërgoj një njoftim me shkrim tatimpaguesit se certifikatat e TVSH-së nuk mund të lëshohet. Njoftimi do të informojë tatimpaguesin për arsyet e mos-lëshimit të certifikatës së TVSH-së dhe t'i përkujtojë tatimpaguesit ndëshkimet për angazhimin në transaksionet me TVSH, pa marrë certifikatën e TVSH-së. Njoftimi gjithashtu do t'i ofrojë tatimpaguesit informatat lidhur me të drejtat e ankesës. ATK do t'i dërgoj tatimpaguesit njoftimin me shkrim brenda 2 ditëve pas përcaktimit se certifikatat e TVSH-së nuk do të lëshohet.

6. Certifikata e regjistrimit për TVSH (ose kopja e vërtetuar) për personin e tatueshëm, duhet të ekspozohet në të gjitha vendndodhjet e personit të tatueshëm ku ai ushtron veprimtarinë. Certifikata duhet të vendoset në një vend të dukshëm me mundësi leximi për konsumatorin, në të kundërtën personi i tatueshëm do t'i nënshtrohet ndëshkimeve të parapara me Ligjin mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Neni 7 **Certifikatat e Import/Eksportit**

1. Personat të cilët dëshirojnë të përfshihen në veprimtari të import/eksportit, kërkohet të marrin një certifikatë import/eksporti para se të ndërmarrin ndonjë aktivitet importi apo eksporti nëse ata:

- 1.1. importojnë mallra në Kosovë, nëse personi nuk është i regjistruar për TVSH,
- 1.2. eksportojnë mallra nga Kosova, nëse personi nuk është i regjistruar për TVSH,

2. Të gjithë formularët e regjistrimit të import/eksportit duhet të dorëzohen personalisht në zyrën regjionale të ATK-së përgjegjëse për çështje tatimore të biznesit nga një person i autorizuar i biznesit. Formularët e regjistrimit të import/eksportit duhet të shoqërohen më një kopje të dokumenteve të regjistrimit të biznesit, certifikatën e numrit fiskal, dhe identifikimin zyrtar me fotografi (pasaportë, kartë identiteti, etj).

3. Me marrjen e formularit për Regjistrim të importit/eksportit, ATK do të sigurojë se informatat në formularin e regjistrimit janë të sakta dhe se tatimpaguesi ka kryer të gjitha detyrimet tatimore. Nëse ATK përcakton se tatimpaguesi ka të drejtë për certifikatë të Import/Eksportit do të shtypë certifikatën dhe t'ia japë atë tatimpaguesit. Nëse tatimpaguesi nuk është aktual në të gjitha parashtrimet e deklarimeve apo pagesave të tatimeve, nuk do t'i lëshohet certifikatë e importit/eksportit deri në kohën kur tatimpaguesi të bëhet aktual në të gjitha çështjet tatimore, apo është vendosur një marrëveshje zyrtare për pagesë të çdo tatimi të papaguar.

4. Secila certifikatë e import/eksportit do të ketë një numër serik unik në faqen e vet.

Neni 8

Çregjistrimi nga TVSH i Personit të Tatueshëm

1. Çdo person i tatueshëm i regjistruar në TVSH në mënyrë të detyruar apo edhe vullnetare, mund të kërkojë nga ATK që të çregjistrohet për qëllime të TVSH-së, nëse në 12 muajt e fundit qarkullimi i tij ka rënë nën pragun e paraparë me nenin 6 paragrafi 1 i Ligjit. ATK do të japë përcaktimin për çregjistrim nga TVSH-ja 12 muaj pas datës së kërkesës për çregjistrim.

2. Nëse brenda 12 muajve pasuese nga dita e kërkesës për çregjistrim, Furnizimet e personit të tatueshëm do të jenë mbi pragun e paraparë me nenin 6 paragrafi 1 të Ligjit, ky person i tatueshëm do të njoftohet nga ATK se nuk i është aprovuar kërkesa për çregjistrim nga TVSH-ja.

3. Nëse brenda 12 muajve pasuese nga dita e kërkesës për çregjistrim, Furnizimet e personit të tatueshëm do të jenë nën pragun e paraparë me nenin 6 paragrafi 1 të ligjit, ky person i tatueshëm do të njoftohet nga ATK se i është aprovuar kërkesa për çregjistrim nga TVSH, dhe ky person detyrohet që ti kthejë ATK-së certifikatën e TVSH-së .

Neni 9

Personi i Tatueshëm i cili ka Mbyllur Veprimtarinë e tij Ekonomike

1. Nëse personi i tatueshëm i cili ka mbyllur veprimtarinë e tij ekonomike, detyrohet të bëjë kërkesë për çregjistrim nga TVSH, deri në ditën e 15 pas datës së mbylljes së

veprimtarisë ekonomike. Me rastin e kërkesës për çregjistrim, ky person duhet t'ia dorëzojë ATK-së certifikatën e tij të TVSH-së dhe të gjithë dokumentacionin e certifikuar.

2. Nëse personi i tatueshëm ka ende stoqe të pa-shitura, ose mjete kapitale, ku TVSH-ja mbi këto mallra ose mjete ose pjesë përbërëse janë tërësisht apo pjesërisht të zbritshme, në bazë të nenit 11, dhe neni 12 i Ligjit, duhet të konsiderohet si person i tatueshëm që është i detyruar të paguajë TVSH-në mbi këtë furnizim. Sipas nenit 24 nënparagrafi 7.1 i Ligjit, furnizimi i tatueshëm duhet të jetë vlera e mallrave dhe mjeteve në fjalë në momentin kur personi i tatueshëm e mbyll veprimtarinë e tij ekonomike.

Neni 10

Aplikimi i Mallrave të Biznesit për Nevoja Jo-biznesore

1. Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 3 i Ligjit, mostrat e biznesit dhe dhurata me vlerë të vogël referuar në nenin 11, paragrafi 2 do të përcaktohet si vijon:

1.1. Mostrat biznesore që referohen në paragrafin 2 të Nenit 11 duhet të konsiderohet mostrat biznesore që drejtpërdrejtë lidhen me kryerjen e aktiviteteve të personave të tatueshëm, që i ofrohen konsumatorëve apo atyre potencial në një sasi të zakonshme që kanë atë qëllim, këto mostra që ofrohen nuk duhet të vihen në shtije tek konsumatorët apo konsumatorët potencial, ose duhet të kenë trajtën që pamundëson shitjen e tyre. Mallrat që jepen si mostra biznesore duhet të shenjzohen si të tilla dhe nëse shenjzohen si mostra biznesore, atëherë patjetër që duhet ta kenë trajtën apo paketimin më ndryshe krahasuar me ato atë cilat e kanë trajtën dhe paketimin që për qëllim kanë shitjen.

1.2. Dhuratat me vlerë të vogël, brenda kuptimit të paragrafit 2 të Nenit 11 të Ligjit, duhet të konsiderohen ato mallra që për qëllim kanë zgjerimin e aktivitetit afarist të personit të tatueshëm, me vlerë individuale të tregut më të ulët se 10 Euro pa TVSH, të cilën personi i tatueshëm herë pas here i jep konsumatorëve apo konsumatorëve potencial pa ndonjë detyrim ligjor për veprim të tillë.

Neni 11

Transferi i Biznesit

1. Furnizimi i mallrave që ndodhë në rastin e transferit të biznesit.

1.1. Sipas nenit 13, kur bëhet një transfer i tillë, nëse këto mallra paraqiten me të gjitha mjetet apo me një pjesë të tyre, nuk ka furnizim të mallrave dhe nuk mund të ngarkohet TVSH-ja. Mallrat transferohen ligjërisht bazuar në dispozitat e të drejtës civile të tilla si: pasuria e patundshme, pasuria paluajtshme, caktimi i vlerës apo transferimi i të drejtave të pronës intelektuale, siç mund të jenë patentat dhe të drejtat tjera pronësore intelektuale. Transferi i biznesit si tërësi nuk është i mundshëm juridikisht sipas të drejtës civile. Termi “transfer i biznesit” duhet të kuptohet në pikëpamjen ekonomike dhe në kuadrin e parimeve të TVSH-së. Të gjitha furnizimet e vetme që lidhen drejtpërdrejtë me transfer të biznesit kuptohen të jenë furnizime të mallrave që ndodhin në rastin e transferit të biznesit.

1.2. Në përgjithësi transferi i biznesit bazohet mbi një kontratë. Një transferim i biznesit bazuar trashëgimi juridike, të tilla si testamentet, kontratat e trashëgimisë, dhe trashëgimia ligjore në rast të vdekjes së personit të tatueshëm që ndodhin jashtë fushëveprimit të Ligjit mbi TVSH-në dhe nenit 13 nuk janë të aplikueshme për këto raste.

2. *Transferuesi si person i tatueshëm.*

2.1. Aplikimi i Nenit 13 kërkon që transferuesi të jetë person i tatueshëm i cili është, ose kërkohet të regjistrohet për TVSH.

2.2. Me fillimin e një aktivitetit ekonomik nga një ndërmarrje biznesore individuale, një subjekt juridik apo një ortakëri këto shoqëri tregtare ,mund të aplikojnë për regjistrim vullnetare sipas Nenit 8 të Ligjit mbi TVSH-në, nëse konfirmohet- nga një dëshmi objektive- që ka qëllim serioz në kryerjen e furnizimeve të tatueshme. Një biznes në periudhën fillestare që është regjistruar vullnetarisht për TVSH mund të konsiderohet si person i tatueshëm duke lejuar zbatimin e Nenit 13 të Ligjit mbi TVSH-në.

2.3. Transferuesi nuk e humb menjëherë statusin e tij si person i tatueshëm me transferimin e biznesit të tij. Statusi i tij si person i tatueshëm përfundon me përmbylljen përfundimtare ose likuidimin e biznesit. Furnizimi ose aplikimi i mjeteve afariste për qëllime të tjera nga ato të biznesit, Neni 11 i Ligjit mbi TVSH, ende konsiderohen si furnizime të tatueshme në vazhdimin e aktiviteteve ekonomike. Ai ka të drejtë të zbres TVSH-në e zbritshme sipas kushteve të përgjithshme të Nenit 36 të Ligjit mbi TVSH-në, kur ai pranon faturat pas transferim ose pas transferimit si kontribut ndaj një kompanie.

3. *Pranuesi i transferit si person i tatueshëm*

3.1. Zbatimi i nenit 13 është i kufizuar në transferim të biznesit të një pranuesi të transferit si person i tatueshëm i cili vepron si i tillë. Në të gjitha rastet tjera të tatuarjes së TVSH-së kërkohet me ligj për konsumin final të pa tatueshëm.

3.2. Pranuesi i transferit mund të regjistrohet për TVSH ose i kërkohet të regjistrohet për TVSH në kohën e transferim të biznesit ose të një pjese të saj, me qëllim të zbatimit të nenit 13.

3.3. Transferimi i një biznesi për qëllime private apo më gjerësisht për qëllime tjera nga ato të biznesit të pranuesit të transferit nuk konsiderohet si një transferim i një tërësie të mjeteve ose një pjese të tyre. Transferi tek një person i tatueshëm si i tillë kërkon që mjetet duhet të përdoren në një biznes ekzistues apo në një biznes të sapo nisur nga pranuesi i transferit. Kjo kërkon që mjetet e transferuara të janë përdorur objektivisht në mënyrë që të lehtësojnë veprimtarinë ekonomike të biznesit të pranuesit të transferit.

3.4. Pranuesi i transferit ka për qëllim të vazhdojë një aktivitet biznesi. Të gjitha transferimet në bazë të nenit 13 janë ato në të cilin pranuesi i transferit ka për qëllim për të operuar me biznesin apo një pjesë të transferit të pranuar dhe jo thjesht synon të likuidojë menjëherë aktivitetin në fjalë dhe t'i shet stoqet, nëse ka ndonjë. Nuk është e domosdoshme që pranuesi i transferit të ushtroj të njëjtin aktivitet ekonomik sikurse transferuesi. Biznesi i blerë gjithashtu mund të integrohet në biznesin ekzistues të pranuesit ose të shfrytëzohet edhe për aktivitete të ndryshme ekonomike. Transferet që nuk përfshihen nga Neni 13 i Ligjit të TVSH-së janë ato kur një person i tatueshëm blen biznesin me qëllim që menjëherë

ta rishes atë ose kur një biznes është blerë nga një konkurrent në mënyrë që ta shpërbëjë ose ta likuadoj atë.

3.5. Nëse tërësia e mjeteve të transferuara është integruar në një biznes ekzistues të pranuesit të transferit me synimin e tij që të vazhdoj të përdor mjetet për aktivitetet e synuara ekonomike dhe në fund e kupton se aktivitetet e planifikuara nuk mund të zbatohet me sukses, nuk do të kërkohet asnjë korrigjim i zbatimit të Nenit 13 të Ligjit për TVSH-së. E njëjta gjë vlen, nëse pranuesi i transferit fillon aktivitetin e tij ekonomik me mjetet e fituara dhe duhet të ndërpres aktivitetin e tij për shkak të rrethanave të cilat paraqiten pas blerjes apo për shkak të mungesës së suksesit ekonomik.

3.6. Nëse mjetet e aplikuara të cilat ishin pjesë e transferimit të një biznesi më pas janë perdore për qëllime private apo përgjithësisht për qëllime të tjera nga ato të biznesit të tij, TVSH-ja mund të ngarkohet për zbatimin e mallrave të biznesit për nevoja jo biznesore, ku TVSH në ato mallra ose pjesëve përbërëse të tyre ishin në tërësi ose pjesërisht të zbritshme nga transferuesi, Neni 11 paragrafi 1 të Ligjit TVSH-së.

3.7. Transferuesi nuk ka të drejtë në rastet e zbatimit të dispozitave të Nenit 13 të Ligjit për TVSH-në të lëshojë një faturë që përfshinë TVSH-në. Nëse ai e bën këtë ai do të jetë përgjegjës për TVSH-në e faturuar. Në raste të tilla, pranuesi i transferit nuk gëzon të drejtën të zbrës TVSH-në.

3.8. Nëse shërbimet e ndryshme të siguruara nga transferuesi për të kryer transferimin e mjeteve ose një pjesë të tyre kanë një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme me një pjesë të qartë të aktiviteve të tij ekonomike, në mënyrë që shpenzimet e atyre shërbimeve formojnë një pjesë të fletëngarkesës së asaj pjesë të biznesit, dhe të gjitha transaksionet në lidhje me atë pjesë janë subjekt i TVSH-në, ai mund të zbrës të gjitha TVSH-të e ngarkuara me shpenzimet e tij për marrjen e këtyre shërbimeve. Edhe në rastin e transferit të gjitha mjeteve, ku personi i tatueshëm nuk ndikon më në transaksione pas përdorimit të këtyre shërbimeve, shpenzimet e tyre duhet të konsiderohen si pjesë e veprimtarisë ekonomike të biznesit si tërësi para transferimit, ECJ C- 408/89.

4. Të gjitha mjetet (Tërësia e mjeteve).

4.1. Një transfer i tërësisë së mjeteve në bazë të nenit 13 të Ligjit për TVSH-në kërkon që të gjitha mjetet themelore të një biznesi ose të një njësie të veçantë të biznesit të organizuar transferohen. Kushti është që një tërësi organike e përbërë prej mallrave dhe të drejtave, elementeve të prekshme ose të paprekshme është transferuar duke i'a bërë të mundur pranuesit të transferit të vazhdojë të zhvillojë atë biznes pa investime të mëtejshme të gjera financiare.

4.2. Në rast të një transferimi të gjitha mjeteve ose të një njësie të veçantë të biznesit të organizuar qoftë për konsiderat apo jo, nuk është bërë asnjë furnizim me mallra, nëse nuk janë transferuar disa mjete themelore. Rregulla e jo-furnizimit e Nenit 13 zbatohet edhe në rastet e një transferimi të një tërësie të mjeteve të biznesit si një kontribut për një kompani, edhe në rast se kemi të bëjmë me një mjet të vetëm themelor, sikurse objektet e biznesit, që nuk janë transferuar legalisht, por i janë dhënë me qira pranuesit të transferit dhe nëse sigurohet që ai biznes zhvillon aktivitet të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm. Nevojitet të lidhet një kontratë afatgjate për lizingun apo qiranë e lokaleve afariste për të disa vite, me mundësi të zgjatjes së kontratës.

4.3. Transferi i një tërësie të mjeteve mund të bazohet në disa kontrata të njëpasnjëshme mbi mjetet e një biznesi, nëse ato janë vendosur në një kontekst kohor dhe faktikisht janë të lidhura me njëri-tjetrin dhe në qoftë se transferimi i një tërësie të mjeteve të biznesit dukshëm dhe padyshim dërgon në mbylljen e biznesit të pranuesit të transferit ose mbylljen e një njësie të veçantë të biznesit të organizuar.

4.4. Për të përcaktuar se cilat mjete kërkohen të jene materialisht dhe thelbesisht të nevojshme, përcaktohet në bazë të gjendjes faktike në kohën kur bëhet transferimi i mjeteve. Edhe objektet e vetme mund të jenë thelbësisht të kërkuara. Objektet e biznesit, stoqet, makineritë dhe pajisjet e përdorura për prodhim janë zakonisht mjetet më të nevojshme të një biznesi prodhues. Të drejtat ekskluzive të shpërndarjes, të drejtat e përdorimit, emri i kompanisë, konsumatorët e rregullt, lidhjet e biznesit dhe marka tregtare mund të jenë mjetet thelbësore.

4.5. Kur kemi të bëjmë me të drejtat e jo-pronësisë, të tilla si e drejta për përdorimin dhe të drejtën për të gëzuar pronën e prekshme dhe të paprekshme dhe marrëdhëniet binzesore që janë pjesë e mjeteve thelbësore të një biznesi, ato duhet të transferohen tek blerësi nëse ato janë të nevojshme për vazhdimësinë e atij biznesi.

4.6. Edhe mjetet e vetme mund të konsiderohen si një tërësi e mjeteve, nëse mjete i vetëm mund të konsiderohet si një njësi e biznesit. Ky është rasti ku një pronar i lokalit i shet lokalet një personi tjetër të tatueshëm së bashku me ndryshimet dhe vazhdimin e kontratave të qerasë. Lokalet dhe kontratat e qirasë konsiderohen si mjete thelbësore.

4.7. Një transferim i mjeteve kërkon që pranuesi i transferit të shndërrohet në pronar ligjor ose pronar ekonomik i mjeteve. Transferimi i të drejtës për të disponuar me pronën e prekshme si pronar duhet të interpretohet si mënyrë e transferimit të së drejtës për të disponuar me pronën e prekshme si pronar, edhe në qoftë se nuk ka transferim të pronësisë ligjore të pronës, ECJ C-320/88.

4.8. Një transferim i një pjese të tërësisë së mjeteve të biznesit konsiderohet si jo-furnizim i mallrave, ku pjesa e transferuar është ekonomikisht e pavarur. Kjo kërkon që një pjesë e një biznesi të transferuar të formojë për veten e saj një njësi të qëndrueshme ekonomike, i cili është në gjendje të zhvillojë aktivitetet e biznesit në mënyrë të pavarur nga aktivitetet e tjera të personit të tatueshëm. Nëse një pjesë e një biznesi mund të konsiderohet si njësi e veçantë e pavarur e biznesit, varet nga rrethanat e përgjithshme dhe faktet e transferimit në kohën e transferimit të mjeteve. Treguesit e tillë janë vendet e ndryshme, ndarjet organizative, mjetet fikse vetanake, stafi i tyre, të dhënat e veçanta të biznesit dhe klientët e tyre të biznesit. Çdo tregues mund të jetë me rëndësi të ndryshme në varësi të llojit të biznesit, p.sh. ofruer i shërbimit, prodhues apo tregtar.

4.9. Transferuesi dhe pranuesi i transferim detyrohen që të njoftojnë ATK-në 30 ditë para se të ndodhë transferi i veprimtarisë ekonomike. Njoftimi i tillë do të bëhet në zyrën Regjionale Përkatëse 30 ditë përpara se transferi i tillë të ndodh, dhe do të për fshij:

4.9.1. Informatat ne lidhje me transferuesin dhe transfer marrësin

4.9.2. Kontrata ne lidhje me kushtet e transferit të biznesit

4.9.3. Specifikat përfshirë përshkrimin, sasinë dhe vlerën e pasurisë e cila transferohet

4.9.4. Vendndodhja e pasurisë që transferohet.

4.10. Një deklaratë, që specifikon detyron për korigjim për secilin mall të kapitalit, që duhet të nënshkruhet nga të dy palët nga furnizuesi dhe pranuesi , dhe e njëjta deklaratë duhet që të dërgohet në ATK më së voni 8 dite pasi që ka ndodhur transferi .

4.11. E drejta e blerësit është që të njoftohet me te gjitha detyrimet e papaguara nga transferuesi, në mënyrë që blerësi të ketë të qartë detyrimet për transferin e këti biznesi. Sa i përket transferimit të pjeserishim të biznesit, duhet të kemi kujdes të bartja e detyrimeve dhe e drejta e kreditimit, kjo duhet të specifikohet qartë nga transferuesi te transfer marrësi.

Neni 12

Vendi i Furnizimit të Shërbimeve

1.Vendi i furnizimit nga një person i tatueshëm, që e ka të themeluar biznesin në një vend jashtë territorit të Republikës së Kosovës, apo e ka të themeluar njësinë fikse atje nga i cili furnizohet shërbimi, apo i cili në mungesë të një vendi të tillë të biznesit apo njësisë fikse e ka adresën e tij të përhershme apo zakonisht banon jashtë Kosovës dhe i cili ofron:

1.1.shërbim të dhënies me qira të mjeteve të transportit në periudhë afatshkurtër apo afatgjatë, apo

1.2.shërbim të përmendur në nenin 20 paragrafi 3.2.9 nga 1 deri në 10, të Ligjit tek nivelet e autoritetit qendror apo lokal dhe për agjencitë tjera të qeverisura nga Ligji derisa këto autoritete nuk njihen si persona të tatueshëm në lidhje me aktivitetet e tyre do të jenë derogime nga paragrafët 3.1, 2.2.5, 3.2.6 dhe 3.2.9 të nenit 20 të Ligjit, nëse shfrytëzimi efektiv dhe zotërimi i këtyre shërbimeve ndodh në Kosovë.

2. Vendi i furnizimit nga një person i tatueshëm, që e ka të themeluar biznesin në Kosovë, apo e ka njësinë fikse atje nga i cili furnizohet shërbimi , apo i cili në mungesë të një vendi të tillë të biznesit apo njësisë fikse e ka adresën e përhershme apo zakonisht banon brenda Kosovës dhe i cili ofron shërbime të dhënies me qira të trenave, autobusëve apo automjete të bëra ekskluzivisht për transportim në rrugë të mallrave tek personi i tatueshëm jashtë Kosovës, do të jenë derogime nga neni 20 paragrafi 2.2.5 i Ligjit, vendi ku pranuesi i këtij shërbimi e ka të themeluar biznesin e tij,ose njësisë fikse për të cilën është ofruar shërbimi nëse shfrytëzimi efektiv dhe zotërimi i këtyre shërbimeve ndodh jashtë Kosovës.

Shembull:

Rasti 1

Komuna A (Prishtinë) në kapacitetin e saj si autoritet publik merr me qira 10 vetura të udhëtarëve nga një kompani qiradhënie të veturave në Tiranë (Shqipëri) për një periudhë 12 mujore dhe 8 vetura tjera për një periudhë prej 28 ditëve. Këto vetura janë vënë në dispozicion Komunës A (Prishtinës) në Shkodër (Shqipëri). Komuna A (Prishtina) nuk është person i tatueshëm sipas përkufizimit të dhënë në nënparagrafin 1.1. të nenit 20.

Vendi i furnizimit të 10 veturave sipas nënparagrafit 3.1 të Nenit 20 të Ligjit mbi TVSH-në është vendi i ku gjendet furnizuesi (Shqipëria). Vendi i furnizimit të 8 veturave sipas nënparagrafit 3.2.6 të Nenit 20 të Ligjit mbi TVSH-në është Shqipëria (Shkodra) vendi ku veturat i janë vënë në dispozicion klientit.

Me akt nënligjor ndryshohet vendi i furnizimit tek vendi ku gjendet pranuesi i furnizimit kur shfrytëzimi efektiv dhe zotërimi ndodh brenda territorit të Kosovës.

Rasti 2

Komuna B (Pejë) në kapacitetin e saj si autoritet publik e angazhon kompaninë këshilluese C nga Gjermania për t'i ofruar asaj propozimet se cili sistem i ri të TI-së është më i përshtatshmi për tu blerë. Komuna B nuk është person i tatueshëm sipas përkufizimit të paraparë në nënparagrafin 1.1. të Nenit 20.

Kompania C nga Gjermania e ngarkon atë me 16, 000 Euro për shërbimet e veta. Kjo konsiderohet si shërbim i konsulencës siç parashihet me nënparagrafin 3.2.9.3 të Nenit 20.

Vendi i furnizimit të shërbimeve që ofrohen nga Kompania C sipas nënparagrafit 3.1 të Nenit 20 të Ligjit mbi TVSH-në është vendi i furnizuesit (Gjermania) shkaku se pranuesi i shërbimit nuk është person i tatueshëm.

Me këtë akt nënligjor vend i furnizimit ndryshohet ku vendi i furnizimit do të jetë vendi i pranuesit të shërbimit ku bëhet shfrytëzimi efektiv dhe zotërimi i shërbimit ku në këtë rast është Kosova.

Rasti 3

Një person fizik nga Mitrovica që nuk është i tatueshëm merr me qira një veturë udhëtarësh për 6 muaj nga një kompani për qiradhënie nga Shkupi. Vetura i vihet në dispozicion atij në Prishtinë.

Vendi i furnizimit sipas nënparagrafi 3.1 të Nenit 20 është Shkupi ku është vendi i furnizuesit.

Me akt nënligjor ndryshohet vendi i furnizimit tek vendi ku gjendet pranuesi kur shfrytëzimi efektiv dhe shfrytëzimi saj ndodhë në Kosovë.

Rasti 4

Një kompani për qiradhënie të kamionëve në Pejë i jep me qira 10 kamion për një periudhë 3 javore një kompanie kroate e cila do t'i shfrytëzon kamionët për transportim ndërmjet Rjekës dhe Sarajevës. Kamionët i dorëzohen klientit në Pejë.

Sipas nënparagrafit 2.2.5 të nenit 20 vendi i furnizimit të shërbimit është Kosova (Peja) ku po dorëzohet pajisja.

Me këtë akt nënligjor ndryshohet vendi i furnizimit tek vendi i pranuesit të saj kur shfrytëzimi efektiv dhe zotërimi i shërbimit ndodhë jashtë Kosovës.

Neni 13 **Vendi i Importit të Mallrave**

1. Vendi i importit të mallrave është vendi ku janë vendosur mallrat në rastin tonë në Kosovë.

2. Mallrat që hyjnë/importohen në Kosovë i dallojmë me karaktere të ndryshme apo përcaktohen në bazë të këtyre regjimeve doganore:

2.1. **Import i rregullt** – nënkuptojnë mallrat që kanë hyrë në Kosovë dhe njëkohsisht kanë paguar detyrimet doganore, dhe këto mallra konsiderohen mallra me status vendor (pra janë mallra të Kosovës). Rexhimi në DUD i kësaj procedure është IM4 – kurse kodi i procedurës doganore 40 00.

2.2. Përveq procedure së hyrjes së mallit përmes importit të rregullt kemi edhe hyrje/importim të mallrave përmes procedurave me ndikim ekonomik (aranzhime tjera), si:

3. **Importimi i mallit përmes procedures se deponimit doganor** – kjo nënkupton hyrjen e mallit në depo doganore, me qëllim që të përfitoj nga shtyrja/prolongimi i detyrimeve doganore nga momenti i hyrjes deri në momentin e shitjes së atyre mallrave në vend. Në momentin e shitjes kryen detyrimet doganore, në rast se këto mallra do të ri-eksportohen atëherë nuk ngarkohen me ndonjë detyrim doganor. Për të siguruar pagesën e detyrimeve doganore duhet të ofrohet mbulueshmëri përmes garancionit bankar, që shuma e garancionit duhet të jetë e barabart me shumën e detyrimeve të atij malli. Rexhimi doganor i hyrjes së mallit me këtë procedurë është IM7 – kodi i procedurave 71 00. Që të realizohet importimi përmes kësaj procedure duhet të ketë paraprakisht autorizim që lëshon Dogana.

4. **Importi i përkohshëm** – nënkupton hyrjen e mallrave me qëllim të qëndrimit për një periudhë të caktuar në vend, dhe më pas të ri-eksportohet. Regjimi doganor është IM5 – kurse kodi i procedurave 53 00. Mallrat në këtë procedurë mund të përfitojnë lirim të plotë dhe lirim të pjesshëm. Për mallrat e importit të përkohshëm me lirim të pjesshëm, në momentin e ri-eksportit i nënshtrohen detyrimeve doganore prej 3% në muaj për sa kohë kanë qëndruar në vend. Importimi – hyrja me procedurën Perpunim i Brendshëm – nënkupton hyrjen/importimin e lëndëve të para apo gjysmë produkteve me qëllim perpunim në vend. Kjo hyrje realizohet përmes dy sistemeve:

4.1. **Sistemi me kthim** – me rastin e importimit subjekti afarist duket të kryej detyrimet doganore, dhe kur kjo lëndë e parë përpunohet dhe ri-eksportohet si produkt i gatshëm apo gjysmë produkt atëherë subjekti në fjalë kërkon kthimin e mjeteve që ka paguar me rastin e hyrjes për mallin që ka ri-eksportuar, kurse për pjesën që i ka mbetur si humbje gjatë përpunimit apo ka ndalur me qëllim për shitje në tregun e brendshëm nuk i kthehen mjetet. Regjimi i këtij importi është IM4 kodi i procedurave 41 00.

4.2. **Sistemi me pezullim** – bëhet importimi i lëndëve të para apo gjysmë produkteve dhe në atë rast importuesi nuk kryen detyrimet doganore, duke konsideruar që i njëjti do të del jashtë vendit për një periudhë të caktuar kohore. Për sigurimin e detyrimeve doganore ofrohet nga subjekti garancion bankar të

barabart me shumën e detyrimeve. Rexhimi doganor i kësaj lloj hyrje është IM5 kod i procedurave është 51 00.

5. Importimi permes procedures se Përpunim nënkotroll doganor – nënkupton hyrjen e pjesëve të caktura të produktit me qëllim formimin e produktit final. Raste të tilla mund të ketë nëse norma tarifore e lëndës së parë mund të jetë më e lartë se norma e produktit të gatshëm të importuar, atëherë përdoret kjo procedurë për të përfituar lehtësira.

6. Për të gjitha këto procedura me ndikim ekonomik kërkohet autorizimi që leshohet nga Dogana e Kosovës

Neni 14

Momenti i Lindjes së Detyrimit dhe Ngarkimit me TVSH për Furnizimet e Mallrave dhe Shërbimeve.

1. Sipas nenit 22 paragrafi 1 i Ligjit, momenti i lindjes së detyrimit për të ngarkuar TVSH-në është momenti kur ndodh furnizimi i mallit apo shërbimit. TVSH bëhet e ngarkueshme varësisht se cili nga tri momentet ndodh i pari:

1.1.furnizim i mallit apo shërbimit,

1.2.lëshimi i faturës në lidhje me furnizimin e mallit apo shërbimit, ose

1.3.pranimi i pagesës në avanc/paradhënje, para se të ketë ndodh furnizimi i mallit apo shërbimit.

Neni 15

Shuma e Tatueshme për Furnizimin e Mallrave dhe Shërbimeve

1. Shuma e tatueshme e një furnizimi të tatueshëm në Kosovë në lidhje me furnizimin e mallrave dhe shërbimeve përfshin çdo gjë që përbën konsideratën e marr ose që do të merret nga furnizuesi që është paraparë për atë furnizim.

2. Nëse furnizimi është marr për konsideratë në para, vlera e tij duhet të merret si shuma e barabartë me konsideratën, në të kundërtën do të aplikohet vlera e hapur e tregut e furnizimit.

3. Shuma e tatueshme duhet të përfshij:

3.1. tatimet, detyrimet, taksat dhe komisionet, duke përjashtuar TVSH-në;

3.2. shpenzimet e rastësishme jo të rregullta si ato të komisioneve, paketimit, transportimit dhe shpenzimeve të sigurimit, të ngarkuara nga furnizuesi për konsumatorin;

- 3.3. për nevoja të nën-paragrafit 3.2 të këtij neni, shpenzimet jo të rregullta mund të mbulohen me marrëveshje të veçantë.
4. Në përjashtim nga kjo kemi shpenzime të paketimit të kthyeshme të cilat nuk bëjnë pjesë në shumën e tatueshme, nëse konstatohet se paketimet e tilla nuk janë kthyer, atëherë keto shpenzime paketimi duhet të përfshihen në shumën e tatueshme.
5. Ambalazhet qarkulluese janë ambalazhe të tipit konteniere, qelqe, arka, bombola apo depozita gazi të lëngshme dhe të tjera të kësaj natyre. Ambalazhet me mallrat që ato përmbajnë duhet të furnizohen në të njëjtën kohë. Këto lloj ambalazhesh jepen nga shitësi (furnitori), së bashku me mallin në to në drejtim të blerësit (klientit); ato ruhen provizorisht nga blerësi dhe më pas kthehen nga ky i fundit përsëri në drejtim të shitësit.
6. Ambalazhet që i janë dhënë blerësit, duhet të kthehen tek shitësi brenda një afati normal sipas fushës së aktivitetit me të cilin ndërlidhen.
7. Ky afat varion edhe sipas natyrës së produktit që ambalazhet përmbajnë dhe duhet të rregullohen në kontratën e lidhur mes palëve.
8. Për mosllogaritjen e TVSH mbi vlerën e ambalazheve qarkulluese duhen plotësuar dy kushtet e mëposhtme:
- 8.1 Vlera që lidhet me ambalazhimin e kthyeshëm të mos jetë përfshirë në vlerën e faturës nga shitësi.
- 8.2 Të ekzistojë një kontratë e lidhur midis palëve për furnizimin si dhe për dhënien dhe kthimin e ambalazheve.
9. Në kontratë paraqitet edhe afati i kthimit të ambalazheve nga blerësi tek shitësi. Ambalazhet që blerësi nuk i kthen tek shitësi konsiderohen sikur të ishin shitur dhe i nënshtrohen TVSH-se mbi vlerën e tyre.
10. Sipas nenit 24, paragrafi 9, kërkohen dëshmitë në vijim kur përjashtohet shuma që lidhet me nenin 24, nënparagrafi 6.3 nga shuma e tatueshme:
- 10.1. fatura e shpenzimeve lëshohet në emër apo në interesin e klientit;
- 10.2. personi i tatueshëm nuk mund ta zbresë TVSH-në e ngarkuar në faturë. Çdo lloj e drejte për zbritje mund të kryhet vetëm nga klienti në emrin e të cilit është lëshuar fatura;
- 10.3. shuma e shpenzimeve duhet regjistrohët në llogarinë e përkohshme të mbajtjes së librave të personave të tatueshëm.
11. Vlera e tatueshme e mallrave të importuara përcaktohet mbi bazën e dispozitave të legjislationit doganor pavarësisht nëse mallrat e importuara janë apo jo të taksueshme me taksa doganore.
12. Vlera e tatueshme e mallrave të importuara përfshin, gjithashtu:
- 12.1. shpenzimet e transportit e të sigurimit dhe shpenzimet e tjera, të përfshira në importimin e mallrave dhe dergimin e tyre, deri në momentin e çastin e hyrjes në territorin e Republikës së Kosovës; si dhe ato që kanë rezultuar nga transporti për

vendin tjetër të destinimit brenda Kosovës, nëse ai vendi tjetër është i njohur kur ka ndodhur momenti i ngarkimit;

12.2. tatimet, detyrimet, taksat dhe detyrimet për t'u paguar jashtë Kosovës, dhe ato që duhet të paguhen shkaku i importimit, duke përjashtuar vjeljen e TVSH-së.

Neni 16

Lirimet për Aktivitetet e Caktuara me Interes Publik

1. **Shërbimet spitalore dhe kujdesi mjekësor.** Duhet të lidhet me shërbimet e mbrojtjes, mirëmbajtjes ose shërimit të shëndetit. Lirimi gjithashtu duhet të lidhet me akomodimin, kujdesin dhe ushqimin e pacientëve, dhe furnizimet tjera që lidhen ngushtë me furnizimet e liruara.

2. Shërbimet spitalore dhe të kujdesit mjekësor janë të liruara vetëm kur këto shërbime kryhen nga një person i cili është i autorizuar për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe mjekësore në Kosovë.

3. Kur furnizimi kryhet nga institucionet private shëndetësore të cilat janë të licencuara nga organet kompetente të Kosovës, është kusht që çmimet e ngarkuara nga furnizuesi i tillë të jenë të krahasueshme me çmimet që ngarkohen nga organet që administrohen me Ligj të Kosovës. Si çmime të krahasueshme janë çmimet të cilat zakonisht nuk i tejkalojnë çmimet që ngarkohen nga Institucionet Shëndetësore Publike bazuar me Ligjet aktuale në fuqi në Republikën e Kosovës që nuk e tejkalojnë shumen më tepër se 30 përqind.

4. Kur qëllimi kryesor nuk e ka për synim mbrojtjen, mirëmbajtjen ose shërimin e shëndetit të personit të caktuar, furnizimi nuk lirohet, si shembull mund të jenë shërbimet kozmetike ose estetike.

5. Kur qëllimi kryesor i shërbimit është t'i ofrojë palës së tretë elementin e nevojshëm për marrjen e vendimit, ky furnizim nuk i nënshtrohet lirimit.

6. **Shërbimet e mirëqenies dhe sigurimit social.** Lirimi tatimor që i referohet nenit 27, nënparagrafi 1.6 i Ligjit i referohet shërbimeve që lidhen me mirëqenien dhe punën e sigurimit social siç mund të jenë furnizimet e bëra nga infermiera, qendrat e kujdesit ditor, shtëpitë e pleqve dhe të ngjashme kur ato furnizohen nga autoritetet kompetente të Kosovës ose nga ndonjë organ tjetër që njihet si autoritet kompetent i Kosovës.

7. Kur furnizimi bëhet nga dikush tjetër e jo nga autoritetet kompetente të Kosovës, është kusht që çmimet që ngarkohen nga një furnizues i tillë të jenë të krahasueshme me çmimet që ngarkohen nga Autoritetet Kompetente të Kosovës. Si çmime krahasuese normalisht do të konsiderohen çmimet që nuk i tejkalojnë çmimet që ngarkohen nga autoritetet që rregullohen me Ligj të Kosovës dhe që nuk janë më të larta 30 përqind.

8. Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve që lidhen drejtpërdrejtë me shërbimet e referuara në paragrafin 1 të këtij neni siç është dërgimi i ushqimit, pijeve medikamenteve dhe të ngjashme gjithashtu duhet të lirohen kur ato furnizohen nga furnizuesi që bënë shërbime të liruara.

9. **Shërbimet e edukimit.** Lirimet nga TVSH-ja për shërbimet e edukimit lidhen me dispozitat në vijim:

9.1. edukimi i fëmijëve, të rinjve, edukimi universitar, trajnimi profesional ose ri-trajnimi, nëse këto shërbime ofrohen, por që janë të akredituara nga institucionet kompetente të Kosovës;

9.2.furnizimet e shërbimeve të përmendura në paragrafin 1 i këtij neni ,janë gjithashtu të lira kur furnizohen nga organizatat tjera që njihen nga autoritetet kompetente të Kosovës që posedojnë qëllim apo aktivitet të ngjajshme kur çmimet që ngarkohen janë të krahasueshme me çmimet që ngarkohen nga organet që rregullohen me Ligj të Kosovës. Si çmime krahasuese normalisht do të konsiderohen çmimet që nuk i tejkalojnë çmimet që ngarkohen nga organet që rregullohen me Ligj të Kosovës dhe nuk janë më të larta se 30 përqind;

9.3. akomodimi dhe ushqimi i nxënësve dhe studentëve në objektet shkollore dhe në shtëpitë e nxënësve dhe studentëve ose të institucioneve të ngjashme po ashtu janë të lira nga TVSH-ja kur këto ofrohen nga furnizuesi që ofron shërbime të lira të edukimit. Të lira janë gjithashtu furnizimet tjera të mallrave ose shërbimeve të cilat janë të lidhura ngushtë me shërbimet e edukimit që janë furnizime të lira kur ato furnizohen ofrohen nga një ofrues që ofron shërbime të edukimit që janë furnizime të lira.

Neni 17

Lirimet për Aktivitete Tjera

1. Organizatat fetare që pranojnë furnizime të lira ose që bëjnë importe të lira ,duhet të mbajnë shënimet dhe librat ,dorëzimi i pasqyrave vjetore do të zbatohen konform Ligjit mbi Procedurat e Administratës Tatimore 2004/48 i plotësuar me amendamente të Ligjit 03/ L – 071. Te gjitha furnizimet për mallra dhe shërbimeve për Religjionet e titulluara duhet argumentohen që furnizimi për këto Religjione ka ndodhur .

2. Nëse mallrat importohen nga një Religjion i titulluar, ky import duhet të specifikojë qartë se malli i importuar nga Religjioni i titulluar është i përdorur ekskluzivisht për nevojat e Religjioni titulluar të parapar në nenin 30 paragrafi 3 të Ligjit.

3. Personi i tatueshëm që bën furnizim të liruar në pajtim me nenin 28 paragrafi 3 tek një organizatë religjioze duhet të marrë një konfirmim me shkrim nga organizata religjioze që e konfirmon se këto mallra dhe shërbime do të shfrytëzohen për qëllime të lirit në pajtim me nenin 28 nënparagrafi 3.1 dhe 3.4.

Neni 18

Lirimet Tjera Speciale Lidhur me Importimin

1. Çfarëdo dërgese që përbëhet nga mallrat të një vlere jo të madhe e cila dërgohet drejtpërdrejt nga një vend jashtë Kosovës , të një pranuës Brenda Kosovës, do t'i lejohet lirimi nga detyrimet e importit.

2. Mallrat me vlere të vogël nënkuptojnë mallrat vlere të përgjithshme të cilave nuk tejkalon Shumën prej 22 euro për secilën dërgesë.

3. Lirimi nuk vlen për:

- 3.1. produkte alkoolike;
- 3.2. parfum dhe ujera tualeti dhe;
- 3.3. duhan e produkteve duhani ;

3. Sipas nenit 30/1.7. të Ligjit mallrat që dërgohen nga një person fizik jashtë Kosovës për një person tjetër që jeton në Kosovë lirohet nga detyrimet e importit , me kusht që ato mallra nuk janë të natyrës komerciale.

4.1. Mallrat e natyrës jo komerciale nënkuptojn :

4.1.1. përmbajnë mallra që ekskluzivisht janë për përdorim personal të pranuesit të dërgesës apo familjes së tij e të cilat sipas natyrës apo sasisë së tyre, nuk lenë dyshim se do të përdoret për qëllim tregtar dhe

4.1.2. i dërgohet pranuesit nga dërguesi pa kurrfarë pagese;

4.2. lejimi i parapar lejohe për dërgesën shuma e të ciles është deri në 45 euro, duke përfshir edhe mallrat që kufizohen në sasi si;

4.2.1 produkte të duhanit:

50 cigare

25 cigarillos (puro e holle e vogël me peshe maksimale deri tri gram secila)

10 cigare puro

50 gram duhan për tymosje

4.2.2. një perzgjedhje propocionale nga këto produkte të ndryshme

4.2.2.1. alkool dhe pije alkoolike;

4.2.2.2. pije të distiluara alkoolike dhe alkool me përbërje mbi 22%; etil alkool i pa denatyalizuar me vëllim 80% e më tepër, 1 litër ose pije të distiluara alkoolike dhe alkool, si dhe aperitiv me baze vere apo alkooli. Pije tafia, sake apo pije të ngjashme alkoolike me përbërje alkooli deri në 22%; verëra shkumbuese, verëra likerit: 1 litër apo një përzirje proporcionale nga këto produkte të ndryshme dhe

4.2.2.3. vere e pa gazuar – dy litra

4.2.3. Parfume – 50 gram , ose uje tualeti: 0.25 litra.

5. Kur vlera e përgjithshme e dërgesës është me e lart se vlera e cekur, ndërsa është e perber prej dy apo me tepër artikuj, lirimi do të lejohe deri në atë shume sikur këta artikuj të ishin importuar ndërsa, duke marr parasysh se vlera e një artikulli të vetëm nuk mund të ndahet.

Neni 19

E Drejta për të Zbritur TVSH-në

1. Një person i tatueshëm mund të zbrës detyrimin e tij të TVSH-së, TVSH-në e detyruar ose TVSH-në e paguar në lidhje me mallrat dhe shërbimet ose ofrimin importit të mallrave të shfrytëzuara ose që do t'i përdor blerjet ose importet për qëllime të transaksioneve të tatueshme ose transaksione të liruara që i dhënë të drejtën e zbritjes.

2. Nëse personi i tatueshëm i ka përdorur ose do t'i përdor blerjet e mallrave ose shërbimet ose importet e mallrave për kryerjen e furnizimeve të liruara në pajtim me nenin 27 dhe 28 të Ligjit personi i tatueshëm nuk ka të drejtë të zbrës TVSH-në e

zbritshme të paguar ose të detyruar në lidhje me ato blerje ose importe. Kur furnizimet që merr një person i tatueshëm, qoftë duke blerë brenda vendit qoftë duke importuar, nuk janë të destinuara për ushtrimin e aktivitetit ekonomike ,sipas nenit 2 paragrafi 1.10 "aktiviteti ekonomik", ai nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e paguar për këto blerje ose importe.

3. Nëse personi i tatueshëm i ka përdorur ose do t'i përdor blerjet e mallrave ose shërbimeve ose mallrat e importuara për transaksione të cilat i dhënë të drejtën e zbritjes dhe për transaksionet të cilat nuk i dhënë të drejtën e zbritjes vetëm ajo pjesë e TVSH-së së zbritshme mund të zbritet siç i atribuohet transaksionit të parë. Proporcioni do të përcaktohet në pajtim me nenin 39 paragrafi 2 i Ligjit.

4. Për të zbritur TVSH-në e zbritshme në lidhje me veturat e udhëtarëve, tatimpaguesi është i detyruar të paraqes dokumentacionin në vijim.

5. Dokumentacioni i cili duhet prezantohet ne këtë rast është: dëshmitë mbi blerjen e veturës (faturë ,DUD),dhe gjitha shpenzimet e ndodhura ,libri udhëtimit (duhet shënohet sakte kilometrat nga nisja deri në destinim të fundit , arsyen e udhëtimit), çdo dokument tjetër relevant që do të arsyetoj shpenzimet e ndodhura.

6. Sipas nenit 36 paragrafi 5.2 TVSH-ja e zbritshme për vetura dhe shpenzimet tjera që lidhen me këto vetura do të njihet në proporcion të shfrytëzimit të asaj veture për qëllime personale dhe biznesore , mirëpo jo më shume se 50% e TVSH-së detyruar ose të paguar në lidhje me këto shpenzime.

7. Bazuar në nenin 36 paragrafi 5.3 nuk pranohet TVSH-ja e zbritshme për shpenzimet e përfaqësimit si vijon :

7.1.shpenzimet për mikpritje dhe zbavitje për kontakte shoqërore;

7.2.shpenzimet e ushqimit dhe pijeve;

7.3. shpenzimet e akomodimit;

8. Nga kjo rregull përjashtohen rastet kur këto shpenzime janë të lidhura drejtpërdrejt me aktivitete biznesore dhe personelin e ngarkuar për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve ku përfshihen punëtori ,agjenti , dhe përfaqësues të tjerë përgjegjës te biznesit. Zbritja pranohet vetëm kur shpenzimi që ndodhë , rezulton në një furnizim të tatueshëm të mallrave ose shërbimeve.

Neni 20

Ushtrimi i së Drejtës për Zbritje

1. Sipas nenit 37, nënparagrafi 3.1 të këtij Ligji, personi i tatueshëm mund të ushtrojë të drejtën e zbritjes bazuar në nenin 36, paragrafi 2.3 i Ligjit që shpjegohet në vijim:

1.1. Sa i përket aplikimit të mallrave sipas nenit 11 dhe nenit 12, të Ligjit ato duhet të trajtohen si furnizime të mallrave për konsideratë po ashtu edhe furnizimi i shërbimeve në bazë të nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit duhet të konsiderohen si furnizim i shërbimeve për konsideratë, për këto personi i tatueshëm duhet të lëshoi një faturë të brendshme të shitjes. Fatura e brendshme e shitjes duhet të përfshijë elementët e aplikueshme që duhet t'i përmbaja fatura siç parashihet me nenin 44 të

këtij Ligji dhe i cili në kuadër të mbajtjes së librave dhe ruajtjes, do të trajtohet si faturë.

1.2. Në qoftë se personi i tatueshëm është duke i aplikuar (përdorur) mallrat ose duke i shfrytëzuar shërbimet që sipas nenit 12, paragrafi 1 ose nenit 16 të këtij Ligji duhet të konsiderohet si furnizim për konsideratë, për një aktivitet për të cilin personi i tatueshëm ka të drejtën e zbritjes së pjesshme, personi i tatueshëm ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e zbritjes së pjesshme mbi bazat e faturave të brendshme të shitjes në pajtim me paragrafin 1 të këtij Neni. Këto fatura të brendshme të shitjes duhet të konsiderohen si fatura siç referohet në paragrafin 2 të nenit 37 të Ligjit.

Shembull:

Shembull Kompania është e përfshirë në furnizimin e shërbimeve financiare të liruara dhe për shërbime këshilluese që janë të tatueshme. E drejta kalimtare e pjesshme e zbritjes në vitin 2011 është 14 përqind. Në vitin 2011 Kompania A i angazhon 8 punëtor ndërtimor për të rinovuar një pjesë të brendshme të ndërtesës së kompanisë. Kjo ndërtesë shfrytëzohet për dy furnizime të tatueshme dhe të liruara. Kjo sipas Nenit 16, paragrafi 1 i Ligjit duhet të konsiderohet si furnizim i shërbimit për konsideratë sepse TVSH për këto shërbime nuk do të jetë plotësisht e zbritshme nëse furnizohet prej një personi të tatueshëm. Renovimi fillon në Shkurt 2011 dhe përfundon në Gusht 2011.

Shuma e tatueshme për këtë furnizim duhet të llogaritet në pajtim me Nenin 24, nënparagrafi 7.3 si vlerë e hapur e tregut. E cila sipas Nenit 24, paragrafi 2 do të thotë se çmimi zakonisht ngarkohet për një furnizim të tillë.

Çmimi që zakonisht ngarkohet nga një kompani ndërtimore për shërbimet që kryhen nga 8 punëtorët ndërtimor vlerësohet të jetë 18,000 Euro në total.

Kompania A duhet të lëshoi një faturë të brendshme të shitjes e cila do të deklaron TVSH e llogaritur me shumën e 18,000 Eurove. Shuma e TVSH-së prej 2,880 Euro duhet të deklarohet si TVSH e llogaritur në Deklaratën e TVSH-së që do të dërgohet për periudhën tatimore të Gushtit 2011.

Në deklaratën e TVSH-së për muajin Gusht 2011 Kompania A në të njëjtën kohë e ka të drejtën e zbritjes së 14 përqind të TVSH-së së llogaritur si TVSH e zbritshme me të drejtë të zbritjes. Fatura e brendshme e shitjes duhet të konsiderohet si faturë siç parashihet me Nenin 37, nënparagrafi 2.1 i Ligjit.

Shumat që lidhen me punën ndërtimore që duhet të deklarohen në Deklaratën e TVSH-së për Gusht X2:

TVSH e Llogaritur 16 % të 18,000	2,880 Euro
TVSH e Zbritshme 14 % të 2,880	403 Euro
Shuma e TVSH-së për t'u paguar	2,477 Euro

Në deklaratën e TVSH-së të dërguar për muajin Janar 2012, kompania B duhet të rregullojë zbritjen e TVSH-së së zbritshme në pajtim me llogaritjet përfundimtare të të drejtës së pjesshme të zbritjes mbi bazat aktuale të shumave qarkullimit për 2011.

2. E drejta e ushtrimit të TVSH-se së zbritshme sipas nenit 37 paragrafi 3.2 dhe neni 36 paragrafi 2.2 të Ligjit kërkohen këto dokumentacione :

2.1.deklaratat doganore te cilat i nenshtrohen detyrimeve doganore me rastin e kalimit te malli ne qarkullim te lire, siq janë:

2.2.deklarata doganore: IM4 – 40 00 , eshte import i rregullt qe i nenshtrohet obligimeve doganore ne baze te normave tarifore, me rastin e hyrjes se mallit.

2.3.deklarata doganore: IM4 – 40 71, eshte malli i zhdoganuar nga depoja doganore

2.4.deklarata doganore: IM4 – 40 51, eshte malli i zhdoganuar nga procedura e perpunimit te brendshem – Sistemi me pezullim.

2.5. deklarata doganor: IM4 – 40 53, eshte mall i zhdoganuar nga importi i perkohshem

2.6.deklarata doganore: IM6 – 61 21, eshte pjesa e mallit te zhdoganuar me rastin e hyrjes se mallit vendor qe ka qene perkohsisht jasht vendit me qellim perpunimi, dhe i nenshtrohet obligimeve vetm per pjesen (vleren e riparuar apo perpunuar).

3. E drejta e ushtrimit te TVSH-se së zbritshme sipas nenit 37 paragrafi 3.2 dhe neni 36 paragrafi 2.1 të Ligjit kërkohen këto dokumentacione :

3.1. fatura Tatimore e lëshuar nga Personi i Tatueshëm i cili ka qenë i regjistruar për TVSH, dhe e cila përmban të gjitha elementet e parapara me nenin 45 të Ligjit;

3.2. nota debitore e lëshuar në pajtimme nenin 47 të Ligjit;

3.3. krahas dokumenteve të përmendura në paragrafin më lartë, për të ushtruar të drejtën e zbritjes së TVSH-së, kërkohen edhe dokumentet si në vijim;

3.4. kontrata mbi Shitblerjen ne qoftese kemi nje kontrat te nenshkruar nga palet kontraktuese;

3.5. dëshmi në lidhje me pagesën nëse shuma e pagueshme është mbi 500 euro ne baze te Nenit 40 Ligjit 2004/48 i plotësuar nga ligji 03/L – 071 ,Neni 24 paragrafi 3 i, dhe neni 11 i Udhezimit 16/2009;

3.6. në rast të investimeve kërkohet që të prezentohen dokumentet e kërkuara me nenin 7 paragrafi 11 të Udhëzimit 16/2009 të datës 01/12/2009 mbi Zbatimin e Ligjit Nr. 204/48, “Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-071, “Mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat”;

3.7. si dhe çdo dokumentacion tjetër përcjellës i cili është relevant në lidhje me transaksionin.

4. E drejta e ushtrimit të TVSH-së zbritshme sipas nenit 37 paragrafi 3.3, dhe në lidhje me transaksionet që i referohen nenit 31, nenparagrafet 1.1; 1.2 dhe 1.4 të Ligjit kërkohen këto dokumentacione :

4.1. dokumenti doganor – ne Eksport per kthim te TVSH-se

4.2. dokumenti doganor: EX1 – 10 00 , nenkupton eksportin e rregull, atëher kur malli vendor eksportohet jashtë.

4.3. dokumenti doganor: EX2 – 21 00, nenkupton eksportin e perkohshem, me qellim te riparimit apo te perpunimi jasht vendin.

4.4. dokumenti doganor: EX3 nenkupton ri-eksportin e mallit te ky regjim doganor kemi disa lloje:

4.4.1. EX3 – 31 41 – nenkupton kur malli qe ka qene ne perpunim – sistemin me kthim, ka kaluar jasht vendit. Ky regjim do te thote qe malli ne momentin e hyrjes ka paguar detyrimet doganore, dhe me rastin e daljes me këtë rexhim, ka të drejt të kërkon nga dogana për kthimin e mjeteve, për pjesen e mallit që ka dalur jasht (ri-eksportuar);

4.4.2. EX3 – 31 51, nenkupron ri-eksportimin e mallit nga procedura e perpunimit te brendshem - sistemi me pezullim;

4.4.3. EX3 – 31 53 – nenkupton riekportimin e mallit nga procedura ne import te perkohshem;

4.4.4. EX3 – 31 71 – nenkupton ri-eksportin e mallit nga procedura e deponimit doganor.

5. Personat e tatueshëm bëjnë zbritjen ne periudhën tatimore ne te cilën ka lindur e drejta e zbritjes në pajtueshmëri me paragrafin 1 te nenit 37 të këtij Ligji. Nëse për çfarëdo arsye, personi i tatueshëm e zbret TVSH-në e zbritshme më vonë se në periudhën kur ai ka pas të drejtë ta zbres, personi i tatueshëm duhet ta njoftojë Menaxherin e zyrës Regjionale në lidhje me rastin, duke ofruar dokumente dhe dëshmi si dhe çdo arsye relevante se pse TVSH e zbritshme nuk është zbritur në periudhën kur ka lind e drejta. Nuk kërkohet aprovimi i kësaj të drejte nga Menaxheri i zyrës Regjionale, por do të ruaj ato dëshmi të ofruara nga personi i tatueshëm në rast të kontrollit të mëvonshëm që mund ti bëhet personit të tatueshëm.

6. Sidoqoftë, tatimpaguesi nuk ka të drejtë të zbres TVSH-në e zbritshme pas periudhës së fundit tatimore të vitit pasues dhe furnizimi i tillë do të konsiderohet të jetë blerje me TVSH të pazbritshme.

Neni 21

Kërkesa për Rimbursim TVSH-së

1. Kompensimet e tatimit mbi vlerën e shtuar

1.1. Në lidhje me nenin 40, paragrafi 1 i Ligjit, nëse shuma e tatimit të zbritshëm në ndonjë periudhë tatimore (p.sh. një muaj) është më e lartë se shuma e tatimit të llogaritur detyruar në të njëjtën periudhë tatimore, tatimpaguesi e ka të drejtën për të bartë kredinë e TVSH-ës tek periudha e ardhshme tatimore. Tatimpaguesi duhet të përdorë këtë kredi tatimi si pagesë të tatimit për periudhën e ardhshme tatimore.


1.2. Mirëpo bazuar në nenin 24 të Ligjit 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat si i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 03/L-071, si dhe bazuar në nenin 40, paragrafi 2 i këtij Ligji, personi i tatueshëm e ka të drejtën e kërkesës për Rimbursim.

1.3. Sipas nenit 40, paragrafi 2.1 i Ligjit, personi i tatueshëm mund të kërkojë rimbursimin e TVSH-së nëse në fund të secilit tremujor kalendarik shuma e kreditit të TVSH-së tejkalon shumën prej 5,000 euro dhe me kusht që personi i tatueshëm të ketë qenë në gjendje kreditimi në fund të secilës periudhë tatimore për TVSH të tremujorit. Gjithashtu kërkohet që personi i tatueshëm të ketë dorëzuar të gjitha

deklaratat e TVSH-së dhe tatimeve tjera për të gjitha periudhat tatimore të kaluara, që nga koha kur Tatimpaguesi ka filluar aktivitetin e tij ekonomik.

1.4. Bilanci i pa shfrytëzuar i tepricës kreditore nënkupton kreditin e tepërt tatimor të mbetur në fund të periudhës pasuese prej tre muaj i cili nuk ka mundur të shfrytëzohet kundrejt detyrimeve të reja të TVSH-së të krijuara për tre muaj pasuese tatimore (tremujori). Ky bilanc i pa shfrytëzuar në fund të muajit 3(tretë),duhet të tejkalojë shumën prej 5,000 euro për tu rimbursuar.

Shembull:



*Rimbursimi është i mundur për vlerën 30.000 euro.
Për eksportuesin nuk vlen ky kusht.*

1.5. Tatimpaguesi ka të drejtë të kërkojë rimbursim deri në ditën e 20 të muajit pas tremujorit kalendarik, që përputhet me afatin e deklarimit të TVSH-së, me kusht që kërkesat të cekura më poshtë të janë përmbushur:

1.5.1. shuma e tatimit të zbritshëm në secilën periudhë tatimore të tremujorit është më e madhe se shuma e tatimit të llogaritur në të njëjtat periudha tatimore të tremujorit;

1.5.2. shuma e krediti të TVSH-ës ka kaluar shumën prej 5.000 euro në periudhën e fundit të tremujorit kalendarik;

1.5.3. tatimpaguesi ka dorëzuar të gjitha deklaratat e TVSH-së dhe deklaratat e tatimeve të tjera për gjitha periudhat tatimore të kaluara.

1.6. Kërkesa e cekur më lartë, duhet të dorëzohet në Shërbimin e Tatimpaguesve në Zyrën Regjionale përkatëse, së bashku me deklaratën e periudhës së fundit të tremujorit kalendarik

1.6.1. Kërkesa e rimbursimit të TVSH-ës duhet të përfundojë brenda 60 ditëve pas marrjes së kërkesës për rimbursim e cila kërkesë është dorëzuar në Zyrën e Shërbimit në zyrën regjionale përkatëse të ATK-së ,pas kësaj date nëse nuk ka arsye të vonësës atëherë do të llogaritet interesi pas ditës 61 të paraparë me legjislacionin e ATK-së, nëse ka arsye të vonësës për shkak të informatave që tatimpaguesi nuk ju ka përmbajtur afateve të parapara me legjislacion atëherë ATK-ja nuk do të llogaritet interesi për vonës.

1.6.2. Personi i cili është duke kryer vetëm aktivitetet e liruara biznesore, siç cekët në Ligjin e TVSH-së 03/L-146 , neni 27, pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritëshme nuk ka mundësi të merr rimbursim të TVSH-së.

1.6.3. Personat të cilët ndërpret aktivitetin e tyre dhe janë në kreditim, p.sh. kreditimi i tatimpaguesit është 3,000 euro për arsye të ndryshme , ky tatimpagues ka të drejt rimbursimi edhe pse kreditimi i tatimpaguesit është nën pragun e paraparë sipas paragrafit 40.2 të ligjit TVSH-së, në këtë rast nuk vlen kushti që tatimpaguesi të ketë kreditimin 5,000 euro.

2. Kërkesat e rimbursimit të TVSH-së në baza mujore, si Rimbursimet për eksporte: nënparagrafi 2.2 i paragrafit 2 neni 40 të Ligjit të TVSH-së

2.1. Tatimpaguesit që biznesi i tyre kryesor apo bizneset kryesore janë eksporti i mallrave që zakonisht kanë tatim më të lartë të zbritshëm se sa tatim të llogaritur për arsye të normës 0% të eksportit. Kërkesat e rimbursimit të eksporteve, që në kompensimet e suksesshme të TVSH-së paraqesin tejkalim të tatimit të zbritshëm, duhet të paguhet pas secilës periudhë tatimore, nëse kushtet e cekura më poshtë janë plotësuar:

2.2.1. transaksionet e eksportit marrin pjesë së paku 25% të transaksioneve totale me të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme; dhe vlera e kreditit të TVSH-së e tejkalon pesëmijë (5000) euro në fund të periudhës tatimore;

2.2.2. personi i tatueshëm t'i përmbushë të gjitha dispozitat e aplikueshme doganore dhe të TVSH-së;

2.2.3. të jenë dorëzuar të gjitha deklaratat e TVSH-së dhe deklaratat e tjera Tatimore për të gjitha periudhat e kaluara;

2.2.4. tatimpaguesi duhet të posedojë dokumentacion të mjaftueshëm për të vërtetuar kërkesën e rimbursimit të TVSH-së.

3. Dëshmitë që duhet t'i posedojë personi i tatueshëm në lidhje me kërkesën e rimbursimit të TVSH-së:

3.1. të gjitha faturat e blerjeve për tre muaj para muajit të krijimit të kreditimit të kërkuar, faturat e blerjeve për muajin në të cilin kreditimi i kërkuar është krijuar, plus faturat e blerjeve për muajt vijues para muajit të kërkesës së rimbursimit të TVSH-së;

3.2. të gjitha faturat e shitjeve për tre muaj para muajit të krijimit të kreditimit të kërkuar, faturat e shitjeve për muajin në të cilin kreditimi i kërkuar është krijuar, plus faturat e shitjeve për muajt vijues para muajit të kërkesës së rimbursimit të TVSH-së ;

3.3. të gjithë dokumentacionin doganor, plus faturat shoqëruese të blerjeve, për të gjitha importet në Kosovë gjatë tre muajve përpara muajit në të cilin kreditimi i kërkuar është krijuar;

3.4. rimbursimi nuk do të lëshohet derisa tatimpaguesi të ketë dorëzuar të gjitha deklaratat tatimore obligative. Një tatimpagues i cili nuk ka dorëzuar të gjitha deklaratat do të konsiderohet se nuk ka dorëzuar kërkesë të vlefshme për rimbursim. Çdo kërkesë rimbursimi e dorëzuar kur tatimpaguesi nuk ka dorëzuar të gjitha deklaratat e kërkuara do të refuzohet.

3.5. deklarimin e biznesit lidhur me shkakun e mbi-pagesës ose balancës kreditore të TVSH-së, sikurse janë investimet, blerjet e pazakonshme të mëdha, etj;

3.6. çdo projekt investim me kontrata afatgjata apo afatshkurta ,projekti investim , dokumente tjera qe argumentojnë investimet si ne objekt,mjete themelore etj.

4. ATK nuk do të bëjë rimbursimin nëse personi i tatueshëm nuk posedon evidencat dhe dokumentet, ose nëse ka indikacione që të dhënat e raportuara në deklaratën e TVSH-së në të cilën është raportuar shuma e rimbursimit të TVSH-së dhe deklaratat e mëparshme të TVSH-së nuk janë të sakta. Indikacionet e tilla duhet të dokumentohen në raport zyrtar–Procesverbal të zyrtarit të ATK-së ose Zyrtarit të Doganës. Raporti i tillë tatimorë siguron evidencë derisa personi i tatueshëm të dëshmojë të kundërtën. ATK me një vendim të arsyetuar duhet të njoftojnë personin e tatueshëm për mbajtjen e Rimbursimit dhe ofrojë shpjegim për arsyet e mbajtjes së rimbursimit;

5. Aplikacioni/formulari i kërkesës për rimbursim të TVSH-ës në Kosove

5.1. Aplikacioni plotëson kompezimin, ndërsa zyra regjionale e tatimit merr vendimet e saja për kompensime në bazë të aplikacionit të tatimpaguesit. Aplikacioni e plotëson kompensim e tatimit mujor duke u referuar në Ligjin e TVSH neni 54.1 nëse aplikacioni dorëzohet më datë 20 të muajit të dytë pas muajit në fjalë, siç përshkruhet në Udhëzimin e TVSH-së.

5.2. Ky aplikacion për kompensim të TVSH-ës është formë e lirë dhe duhet të paraqes së paku informatat e cekura më poshtë:

5.2.1. emri i aplikuesit (tatimpaguesit)

5.2.2. numri fiskal i tatimpaguesit

5.2.3. adresa vendi i tatimpaguesit

5.2.4. numri i llogarisë bankare

5.2.5. personi kontaktues , emri ,adresa kontaktuese dhe numri i telefoni të tij/saj

5.2.6. periudha tatimore

5.2.7. lloji i tatimit

5.2.8. shuma e rimbursimit për periudhën.

5.3.Përshkrimi i çështjes dhe bazamentit

5.3.1. përse tatimi i zbritshëm i aplikuesit tejkalon tatimin e llogaritur apo

5.3.2. nëse ka pasur gabime të më hershme , si shembull

5.3.3. tatimi i llogaritur mund të jetë ngarkuar gabimisht për arsye të mosnjohjes së ligjit apo gabimeve matematikore

5.3.4. data

5.3.5. Nënshkrimi (nënshkrimi duhet të jetë i personit të autorizuar apo i personit përgjegjës).

Neni 22

Rregullimet e Zbritjeve

1. Zbritja fillestare e TVSH-së së zbritshme korrigohet atëherë kur shfrytëzimi i mallrave kapitale pëson ndryshim që ndikon në të drejtën e personit të tatueshëm në zbritjen shumë të më të vogël apo më të lartë. Korrigjimi vjetor duhet të bëhet vetëm për një të njëzetën (1/20) e pasurisë së paluajtshme dhe një të pestën (1/5) e mallrave tjera kapitale mbi TVSH-në e ngarkuar për mallrat kapitale. Korrigjimi duhet të bëhet mbi bazat e ndryshimeve të të drejtës së zbritjes për vitet pasuese që ndërliken me vitin kur mallrat kapitale janë pranuar. Personi i tatueshëm nuk është i obliguar të korrigojë zbritjen nëse diferenca e TVSH-se se zbritshme është me e ulet se njëzet euro(20 euro). Korrigjimi për secilin vit kalendarik duhet të bëhet përmes deklaratës tatimore më së voni në Janar të muajit pasues kalendarik.

2. Nëse mallrat kapitale furnizohet gjatë periudhës së korigjimit duhet të vepohet si vijim:

2.1. në qoftë se furnizimi tatóhet, mallrat kapitale duhet të konsiderohen se shfrytëzohen plotësisht për qëllime tatimore për periudhën e mbetur të korigjimit. Në qoftë se tatimpaguesi nuk ka pasur të drejtë të bëjë zbritjen e plotë të TVSH-së së zbritshme, korigjimi mund të kryhet për periudhën e mbetur korigjuese të periudhës tatimore kur mallrat e kapitalit janë furnizuar. Korigjimi nuk mund të tejkaloj 16% të çmimit të shitjes pa TVSH;

2.2. në qoftë se furnizimi nuk tatóhet, mallrat kapitale duhet të konsiderohen se shfrytëzohen për qëllime që nuk janë të tatueshme për periudhën e mbetur korigjuese. Në qoftë se tatimpaguesi ka pasur të drejtën për zbritje të plotë apo të pjesërishtme të TVSH-së së zbritshme, korigjimi duhet kryhet për periudhën e mbetur të korigjimit të periudhës tatimore kur janë furnizuar mallrat kapitale;

2.3. në qoftë se furnizimi, sipas nenit 13 të Ligjit, nuk duhet të konsiderohet si furnizim i mallrave për konsideratë, obligimi i korigjimit të mallrave kapitale në fjalë i transferohet pranuesit. Një deklaratë, që specifikon obligimin për korigjim për secilin mall të kapitalit, që duhet të nënshkruhet nga të dy palët nga furnizuesi dhe pranuesi dhe duhet t'i dërgohet ATK-së jo më vonë se 8 ditë, obligimi korigjues bëhet i obligueshëm menjëherë për pjesën e mbetur të korigjimeve dhe pranuesi dhe furnizuesi janë bashkërisht përgjegjës. ATK mund të vendos se a do të ketë nevojë për një formular të veçantë për përdorim të një deklaratë të tillë.

3. Në qoftë se një ndërtesë ose pajisje bëhet e pashfrytëzueshme përpara se t'i skadojë afati periudhës së korigjimit të TVSH-së së zbritshme, atëherë arsyet për korigjim të TVSH-së së zbritshme duhet të ndërpriten.

4. Në qoftë investimet pasuese nuk e ndryshojnë në thelb jetëgjatësinë e shfrytëzimit të ndërtesës ose pajisjes, atëherë korigjimi i TVSH-së së zbritshme për atë investim duhet të kryhet në periudhën e korigjimit të TVSH-së së zbritshme për mallrat kapitale në fjalë.

5. Nëse bëhet një investim pasues i cili në thelb e ndryshon jetëgjatësinë e shfrytëzimit ose paraqet një njësi të ndarë siç mund të jetë psh. një pjesë e shtuar të një ndërtesë ekzistuese , një periudhë (e veçantë) korigjimit të TVSH-së së zbritshme duhet të përcaktohet për këtë investim.

Shembulli 1

Korigjimi i zbritjes së TVSH-së së zbritshme për mallrat kapitale

Kompania A kryen dy lloje furnizimesh të tatueshme me TVSH të liruara.

Pas fundit të çdo viti, Kompania e llogarit qarkullimin e vet të cilën e ndanë në furnizime të tatueshme dhe në furnizime të liruara si në vijim:

Viti	Furnizimet e tatueshme me TVSH	Furnizimet e Liruara	Qarkullimi Total	E drejta për zbritje të pjesshme
2009	160	150	310	52
2010	140	150	290	49
2011	170	140	310	55
2012	130	50	180	73
2013	210	680	890	24
2014	300	80	380	79
2015	150	150	300	50
2016	260	300	560	47
2017	150	150	300	50
2018	0	250	250	0
2019	0	50	50	0
2020	0	300	300	0
2021	150	150	300	50
2022	170	140	310	55
2023	130	50	180	73
2024	210	680	890	24
2025	300	80	380	79
2026	150	150	300	50
2027	260	300	560	47
2028	150	150	300	50
2029	0	250	250	0

E drejta për zbritje të pjesshme në pajtim me Nenin 39, paragrafi 4 të Ligjit duhet të rumbullakohet me një numër të plotë.

Kompania A e blen një ndërtesë komerciale në Shtator 2010. Blerjes i vjelet TVSH-ja në vlerë prej 250,000 Euro. Kompania A e pranon faturën në lidhje me blerjen e ndërtesës në Shtator 2010 dhe fillon të shfrytëzojë ndërtesën po ashtu në Shtator 2010. Kompania A do ta shfrytëzojë këtë ndërtesë për kryerjen e të dyja furnizimeve atyre të tatueshme dhe të liruara.

Sa mund të zbres Kompania A në Shtator 2009?

Llogarit shumën që mund ta zbresë Kompania A si dhe korrigjimet vjetore të zbritjes së TVSH-së zbritshme që do të kryhen nga Kompania.

Zgjidhja

Në Shtator 2010 Kompania A mund të zbres 130,000 Euro. Arsyeja për këtë është se zbritja e pjesshme mund të aplikohet paraprakisht gjatë vitit 2010 që është 52 përqind e normës së zbritjes së pjesshme të llogaritur për vitin 2009.

Në deklaratën e TVSH-së që duhet të dorëzohet në Janar 2010, kompania duhet të korrigjojë zbritjen e kryer paraprakisht në pajtim me normat aktuale të zbritjes të llogaritura mbi bazat e shumave të qarkullimit për vitin 2010 që llogaritet për 49 përqind. Prandaj, kompania duhet të zvogëlojë zbritjen e TVSH-së së zbritshme me 7,500 Euro që është diferenca ndërmjet të drejtës paraprake të zbritjes së pjesshme dhe të drejtës aktuale për zbritje të pjesshme për vitin 2010.

Në vijim janë renditur korrigjimet e bëra për secilin vit.

Viti	Zbritja e mundshme për vit	Zbritjet e kryera më herët në vit	E Drejta e Zbritjes	Korrigjimi Vjetor
2010	12,500	6,125	6,125	0
2011	12,500	6,125	6,875	750
2012	12,500	6,125	9,125	3,000
2013	12,500	6,125	3,000	-3,125
2014	12,500	6,125	9,875	3,750
2015	12,500	6,125	6,250	125
2016	12,500	6,125	5,875	-250
2017	12,500	6,125	6,250	125
2018	12,500	6,125	0	-6,125
2019	12,500	6,125	0	-6,125
2020	12,500	6,125	0	-6,125
2021	12,500	6,125	6,250	125
2022	12,500	6,125	6,875	750
2023	12,500	6,125	9,125	3,000
2024	12,500	6,125	3,000	-3,125
2025	12,500	6,125	9,875	3,750
2026	12,500	6,125	6,250	125
2027	12,500	6,125	5,875	-250
2028	12,500	6,125	6,250	125
2029	12,500	6,125	0	-6,125

Secili korrigjim duhet të bëhet në deklaratë të TVSH-së që do të dërgohet në Janar të vitit pasues.

Shembulli 2

Kompania B është duke e drejtuar një barnatore dhe një supermarket. Kompania B nuk është e regjistruar për TVSH shkaku se qarkullimi i saj nuk e tejkalon pragun që referohet në Nenin 6 të Ligjit. Në vitin 2010 kompania e blen një kamion. Kamioni kryesisht shfrytëzohet në lidhje me punët e supermarketit por gjithashtu shfrytëzohet edhe për punët e barnatores. Çmimi i kamionit ka kushtuar 21,000 Euro. Kompania e ka pranuar faturën prej furnizuesit, i cili është i regjistruar për TVSH, ku në këtë faturë TVSH është ngarkuar me vlerën 3,360 Euro.

Në vitin 2010 kur kompania e ka blerë kamionin nuk ka mundur të zbres TVSH-në shkaku se nuk është e regjistruar për TVSH.

Në Maj të vitit 2012 qarkullimi i kompanisë e tejkalon pragun për regjistrim të obliguar dhe për këtë arsye kompania e dërgon aplikacionin për regjistrim që kjo do të hyjë në fuqi kur personi bëhet person i tatueshëm që nga 10 Qershori 2010.

Në vitin 2013 vëllai i pronarit të kompanisë do të shpërngulet në Athinë. Pronari i shfrytëzon kamionin për ta dërguar vëllain me gjësendet e tij në Athinë. Ai nuk e ngarkon vëllain e tij me ndonjë çmim për këtë shërbim të ofruar.

Pas përfundimit të secilit vit tatimpaguesi A ka llogaritur qarkullimin dhe e ka ndarë si në vijim:

Viti	Supermarketi para se të regjistrohet	Supermarketi pas regjistrimit	Barna torja	Qarkullimi total	E drejta e zbritjes së pjesshme
2010	150	0	150	300	0 (No reg.)
2011	170	0	140	310	0 (No reg.)
2012	150	160	240	550	30 %
2013		450	400	850	53 %
2014		500	600	1,100	46 %

E drejta e zbritjes së pjesshme duhet të rrumbullakohet me numrin e plotë në pajtim me Nenin 39, paragrafi 4 i Ligjit.

Llogarit shumën e TVSH-së që mund të zbritet nga Kompania A në periudhën 2010-2014.

Zgjidhja

Qarkullimi të cilin ai ka të drejtë të zbres është vetëm qarkullimi i gjeneruar prej 10 Qershorit 2010 kur kompania është bërë person i tatueshëm i regjistruar.

Transportimi i vëllait me gjësendet e tij në Athinë sipas Nenit 15, paragrafi 2 të Ligjit do të trajtohet si furnizim për konsideratë. Shuma e tatueshme për këtë shërbim është në pajtim me Nenin 24, nënparagrafi 7.2. të Ligjit është shpenzim i plotë për ofrim shërbimi. Për këtë shërbim Kompania B duhet të lëshoj një faturë të brendshme të shitjes mbi të cilën do të ngarkojë TVSH e llogaritur. Shuma e tatueshme për këtë shërbim paraqitet në qarkullim të supermarketit. Shfrytëzimi privat i kamionit nuk ndikon në zbritjen e TVSH-së për kamionin. Në vend të saj shfrytëzimi privat etj. do të trajtohet si furnizim për konsideratë në pajtim me Nenin 15 të Ligjit.

Viti	Zbritja e mundshme për vit	Zbritjet e bëra paraprakisht për vit	E drejta e zbritjes	Korrigjimi vjetor
2010	672	0	0	0
2011	672	0	0	0
2012	672	0	201	202
2013	672	0	356	356
2014	672	0	309	309

Kompania B ka të drejtë të zbres shumat në vijim si TVSH të zbritshme në deklaratat e TVSH-së për:

Janar 2013:	202 Euro
Janar 2014:	356 Euro
Janar 2015:	309 Euro

Neni 23

Zbritjet e TVSH-së së Zbritshme në Fillimin e Aktivitetit Ekonomik si Person i Tatueshëm i Regjistruar për TVSH.

1. Siç është paraparë me nenin 42 paragrafi 1 i Ligjit kur një person bëhet person i tatueshëm qoftë me kalimin e pragut të paraparë me nenin 6 paragrafi 1 i Ligjit apo qoftë i regjistruar si vullnetarë sipas nenit 8 të Ligjit, ky person i tatueshëm ka të drejtë që në periudhën e parë tatimore kur bëhet person i tatueshëm i regjistruar, të njohë TVSH-në e zbritshme për të gjitha mallrat që ka në stoqet e tij në ditën para se regjistrimi të jetë i vlefshëm. Kushtet që duhet të plotësohen për të ushtruar këtë të drejtë janë si në vijim:

- 1.1. mallrat që do të shfrytëzohen për kryerjen e furnizimeve që e kanë të drejtën e zbritjes;
- 1.2. personi i tatueshëm duhet të disponojë listën e stoqeve të specifikuar në sasi dhe ma datën e regjistrimit të stoqeve në ditën para se të jetë bërë person i tatueshëm;
- 1.3. duhet që të ketë faturë me TVSh siq është e paraparë në Kreun 15 të Ligjit;
- 1.4. duhet të ofrojë evidencë për regjistrimet siq është e paraparë me Legjislacionin tatimor.

2. Siç është paraparë me nenin 42 paragrafi 2 i Ligjit, personi i cili bëhet person i tatueshëm, do ta ketë të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme, në periudhën e parë tatimore kur regjistrimi është bërë i vlefshëm.

3. Nëse personi i tatueshëm ndodh e ka zbritur TVSH-në për mallrat në stoqe, dhe më vonë ato stoqe do të shfrytëzojnë si furnizime të liruara pa të drejtë të zbritjes së TVSH-së së zbritshme duhet të aplikohet Neni 12, paragrafi 2 i Ligjit, që si rrjedhojë ka TVSH-në e llogaritur duhet të paguhet nga personi i tatueshëm, në periudhën kur mallrat do të shfrytëzohen si furnizime të liruara pa të drejtë të zbritjes. Një faturë e brendshme e shitjes duhet të lëshohet në raste të tilla.

4. Gjithashtu nëse personi i tatueshëm ka kreditim të TVSH-së në fund të tremujorit për shkak se ka e ka zbritur TVSH-së në mallra në stoqe, atëherë ky person nuk do të ketë të drejtë që të bëjë kërkesë për rimbursim, në lidhje me kreditimin që është rezultat i zbritjes së TVSH-së për stoqe kur ai/ajo bëhet person i tatueshëm.

Neni 24

Dispozitat e Veçanta

1. Sipas kërkesave të nenit 51, paragrafi 3, secili person i tatueshëm duhet të udhëheqë dhe mbajë dokumentet siç janë të përshkruara në kapitullin 15 të Ligjit. Gjithashtu ai është i detyruara që të mbajë dhe udhëheqë dokumentet e tjera si në vijim:

1.1. dokumenti i transportit/ fletë-dërgesa – siç është përshkruar në nenin 9 paragrafi 1.2 i Udhëzimit nr 16/2009 për zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat;

1.2. dokumenti i pranimit të Dërgesave - Duhet të jetë një dokument i cili dëshmon se malli është pranuar nga personi i autorizuar për pranimin e mallit. Në këtë dokument përveç të tjerash duhet të përfshihen në detaje përshkrimi i llojit dhe sasive të mallit të pranuar;

1.3. regjistrimet dhe shënimet detale në lidhje me punën në proces duhet të ofrohen dëshmi relevante në lidhje me sasi të mallrave që zhvendosen duke filluar nga lënda e parë, gjysmë produkti e deri te produkti final;

1.4. lëvizja e mallit duhet të dëshmohet me dokumentacion relevant në vendin apo vendndodhjet e tatimpaguesit nëse ka më shumë se një vend ku ushtron afarizëm. Në këtë dokument përveç të tjerash duhet të përfshihen në detaje përshkrimi i llojit dhe sasive të mallit që ka lëvizur;

1.5. në rastin e dhënies së mallit në Konsignacion si dokument relevant për të dëshmuar se mallrat janë dhënë në konsignacion do të jenë Kontrata e cila specifikon të gjitha kushtet e marrëveshjes së konsignacionit si dhe dokumentacioni përcjellës për lëvizjen e mallrave i cili përveç të tjerash duhet të përfshijë në detaje përshkrimi i llojit dhe sasive të mallit që ka lëvizur.

Neni 25

Personat e Detyruar për të Paguar TVSH –

1. Mjetet kryesore ,shtyerja e TVSH-së

1.1. Në lidhje me nenin 52.3. të Ligjit , shtyerja e afatit të TVSH-së në Mjetet Kryesore do të lejohet për bizneset , në importin të makinerisë dhe pajisjes që bien nën Kapitujt 84 dhe 87 të Nomenklaturës së Harmonizuar të Sistemit të Mallrave. Makinaria dhe pajisja mund të jenë të reja apo të përdorura dhe do të shfrytëzohen për prodhimin e mallrave dhe shërbimeve tjera.

1.2. Më qëllim të përfitimit nga kjo shtyerje bizneset do të kërkojnë nga Administrata Tatimore duke dorëzuar njw aplikacion. Aplikuesi duhet t'ia bashkangjesë aplikacionit kopjen e planit të biznesit, kopjen e kontratës me shitësin e makinerisë apo pajisjes, xhirollogarin për të mbuluar pjesën e TVSH-së, një plan të uzinës apo fabrikës, lejen e ndërtimit të dhënë nga agjensitë e autorizuara.

1.3. Administrata Tatimore do të shqyrtojë kërkesat dhe do t'u dhurojë shtyerje të afatit aplikantëve të cilët përmbushin kushtet e besueshmërisë. Miratimi apo refuzimi të bëra me shkrim do t'i lëshohen nga Administrata Tatimore aplikantit dhe një kopje do t'i dorëzohet Shërbimit Doganor përpara se importimi të bëhet. Biznesi do t'i japë njoftim paraprak Shërbimit Doganor të datës që parashihet dhe vendit të hyrjes së mallrave në Kosovë. Në kohën e importimit, Shërbimi Doganor do të kërkojë nga pronari i mallrave letrën e miratimit të lëshuar nga Administrata

Tatimore dhe të verifikojë se korrespondon me letrën e miratimit të dërguar përpara Doganës nga Administrata Tatimore. Shërbimi Doganor do të llogarisë shumën e shtyrë të TVSH-së për mjetin kryesor dhe të shkruajë “E Shtyrë” pranë shumës së TVSH-së në Deklaratën Doganore. Shërbimi Doganor do të njoftojë Administratën Tatimore për shtyrjen (e afatit) në kohën e arritjes.

1.4. Personi i tatueshëm ka 6 muaj të kompensoje TVSH-në ndaj tatimit të llogaritur. Nëse gjatë periudhës gjashtëmujore personi i tatueshëm fillon të furnizojë mallrat dhe shërbimet e tatueshme, personi i tatueshëm do të përgatisë faturën tatimore me vlerën e mjetit kryesor dhe tatimin mbi vlerën e shtuar përkatës. Të dhënat në faturën tatimore do të korrespondojnë me të dhënat në deklaratën doganore. Të dhënat e faturës tatimore do të regjistrohen në dy librat si të shitjes ashtu edhe të blerjes, duke bërë zero TVSH-në për mjetin kryesor dhe TVSH-ja e llogaritur që është ngarkuar dhe mbledhur nga blerësit do të derdhet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (pas zbritjes së ndonjë TVSH-je të zbritshme potenciale në blerjet e tjera).

1.5. Në qoftë se në fund të periudhës 6 mujore tatimi mbi vlerën e shtuar nuk është paguar, Administrata Tatimore do të kërkojë nga banka të mbulojë ndryshimin nga garancioni. Kurrëfarë krediti i tatimit të zbritshëm nuk do të lejohet derisa përfituesi i shtyrjes së afatit të fillojë furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të tatueshme.

Neni 26 **Ngarkesa e Kundert**

1. Detyrimi për të Paguar TVSH-në për Shërbimet që Furnizohen nga një Person i tatueshëm që nuk është i themeluar në Kosovë dhe e drejta e ushtrimit të TVSh-së zbritshme sipas nenit 37 paragrafi 3.4. i Ligjit .

1.1. Neni 19 i Ligjit mbi TVSH-në e rregullon vendin e furnizimit të mallit, ndërsa, Neni 20 i Ligjit TVSH-se e rregullon vendin e furnizimit të shërbimit . Në vijim do të shpjegohet në detaje se kush është personi që është i detyruar të paguajë TVSH-në dhe obligimet tjera që lidhen me furnizimet e mallrave dhe shërbimeve që e kanë vendin e furnizimit në Kosovë por që furnizohen nga personi i tatueshëm që nuk e ka njësinë e themeluar në Kosovë.

1.2. Ky udhëzim administrativ nuk i shpjegon rastet kur shërbimet konsiderohen se kanë vendin e furnizimit në Kosovë.

2. Kur pranuesi është i regjistruar për TVSH në Kosovë

2.1. Është i detyruar të paguajë

2.1.1 Sipas Nenit 52 të Ligjit mbi TVSH-në personi i obliguar të paguajë TVSH-në është personi i cili kryen furnizime të tatueshme. Sidoqoftë, kur furnizimi kryhet nga një person i tatueshëm që nuk është i themeluar në Kosovë tek një person i cili është i regjistruar për TVSH në Kosovë, personi që ka për detyrim të paguajë TVSH-në mbi atë furnizim, është pranuesi e jo furnizuesi.

2.2. Faturimi

2.2.1. Edhe pse furnizuesi nuk është i obliguar të paguajë TVSH-në ai ende është i obliguar të lëshoi një faturë në pajtim me Nenin 45 të Ligjit mbi TVSH-në.

2.2.2. Furnizuesi duhet të cekë në faturë se klienti është i obliguar të paguajë TVSH-në duke e vendosur aty referencën e Nenit 52, paragrafi 2 të Ligjit mbi TVSH-në apo ndonjë referencë tjetër që tregon se furnizimi do t'i nënshtrohet procedurës së ngarkesës së kundërt. Teksti në vijim do të konsiderohej si i duhur: *“Ngarkesa e kundërt, nënparagrafi 1.2 i Nenit 52 i Ligjit mbi TVSH-në në Kosovë”*.

2.3. Llogaritja e TVSH-së

2.3.1. Pranuesi i furnizimit duhet të llogarisë TVSH-në mbi të dhënat e faturës së pranuar nga furnizuesi. Sidoqoftë, pranuesi duhet të sigurohet se baza tatimore llogaritet në pajtim me Nenin 24 të Ligjit mbi TVSH-në. Rrjedhimisht, pranuesi duhet të sigurohet se baza tatimore përfshin çdo gjë që përmban konsideratën e fituar ose që do të fitohet nga furnizuesi, në kthim të furnizimit.

2.3.2. Detyrimi i pranuesit për pagim të TVSH-së nuk kushtëzohet nga kuponi i faturës së furnizimit. Prandaj, në qoftë se pranuesi nuk e pranon faturën e furnizimit ai prapë duhet të deklarojë këtë shumë në Deklaratën e TVSH-së për periudhën përkatëse tatimore dhe të paguajë TVSH-në.

2.4. Lindja e detyrimit ne periudhen Tatimore

2.4.1. Kjo shpjegohet në Nenin 22 të Ligjit mbi TVSH-së se kur TVSH bëhet e detyrueshme.

2.4.2. Në bazë të kësaj dispozite TVSH bëhet e detyrueshme në momentin kur kryhet njëri nga aktivitetet në vijim, ai që është më i hershmi:

2.4.3. kryerja e shërbimeve;

2.4.4. lëshimi i faturave ose pagesa apo pagesa e pjesërishme e bërë para se të lëshohet fatura;

2.4.5. Furnizimi i vazhdueshëm me shërbime pas një periudhe kohore duhet të njihet si i kompletuar së paku në interval një mujor.

2.5. Përfshirja e TVSH se ngarkueshme ne deklaraten e TVSH-së

2.5.1. Pranuesi duhet të përfshijë tatimin e llogaritur të TVSH së detyrueshme për furnizimet e shërbimeve nga furnizuesi që nuk është i themeluar në Kosovë.

2.6. Zbritja

2.6.1. Pranuesi me të njëjtën deklaratë të TVSH-së ka të drejtë të zbres shumën e TVSH-së të deklaruar si TVSH e llogaritur në pajtim me Kreun XIII të Ligjit mbi TVSH-në.

2.6.2. Nëse pranuesi nuk ka pranuar faturë nga furnizuesi kushti i referuar në Nenin 37 paragrafi 2.1 në lidhje me lejimin e zbritjes që e lejon të bëjë këtë vetëm nëse tatimpaguesi e posedon faturën e furnizimit, nuk bënë të aplikohet në lidhje me zbritjen e TVSH së llogaritur që është llogaritur për furnizimet e pranuar nga furnizuesi që nuk e ka njësinë të themeluar në Kosovë.

2.7. Regjistrimi i TVSH-së dhe përfaqësuesi tatimor

2.7.1. Kur zbatohet procedura e ngarkesës së kundërt dhe si pasojë pranuesi është i obliguar të paguajë TVSH-në, në këtë rast furnizuesi nuk është i obliguar të regjistrohet në Kosovë ose të caktojë përfaqësues tatimor.

3. Kur pranuesi nuk është i regjistruar për TVSH

3.1. Kur një person i tatueshëm që nuk është i themeluar në Kosovë kryen një furnizim ku vendi ku është kryer ai furnizim njihet të jetë Kosova, tek një person i cili nuk është i regjistruar për TVSH në Kosovë, furnizuesi është i obliguar të regjistrohet për TVSH në Kosovë, përpara se ta kryejë furnizimin në Kosovë.

3.2. Furnizuesi që nuk është i themeluar në Kosovë duhet të emëroj një përfaqësues tatimor. Furnizuesi duhet të regjistrohet në emrin e tij dhe me emrin e përfaqësuesit tatimor brenda pesë ditëve pas emërimit të përfaqësuesit tatimor dhe përpara se të fillojë aktivitetin ekonomik në Kosovë.

3.3. Përfaqësuesi tatimor është i detyruar të paguaj TVSH-në për furnizimet në Kosovë për personin e tatueshëm që e përfaqëson për furnizimet që i bënë tek personat që nuk janë të regjistruar për TVSH në Kosovë.

Shembulli 1

Një avokat nga Austria angazhohet nga Banka "X" në Prishtinë për të përfaqësuar atë në një rast në gjykatë, me arsyen sepse banka është paditur për një shitje të paligjshme në një ankand të një ndërtese që është vënë si kolateral për kredi, për të cilën kështet nuk janë paguar në datat e marrëveshjes të përcaktuara në kontratën e kredidhënies.

Banka është e regjistruar për qëllime të TVSH-së për aktivitetet në vijim:

1. Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e letrave me vlerë
2. Dhënie me qira të kasafortave
3. Dhënie me qira (lizingun) e pasurisë së luajshme dhe të paluajshme

Avokati Austriak për shërbimet e veta e ngarkon Bankën X me një çmim prej 7,500 Euro.

Shpjegoni sesi trajtohet TVSH për shumën e ngarkuar nga avokati për ofrimin e ndihmës ndaj bankës në gjykatë që lidhet me furnizimet bankare të TVSH-së të cilat janë të liruara për transaksionet e dhënies së kredive.

Zgjidhja

Së pari duhet të përcaktohet vend i furnizimit për shërbimet e furnizuara nga Avokati. Banka është person i tatueshëm bazuar në përkufizimin e veçantë që parashihet nga nënparagrafi 1.1. i Nenit 20. Në këtë rast vendi i furnizimit të shërbimit është Kosova sipas nënparagrafit 2.2 të Nenit 20.

Së dyti, është e nevojshme të përcaktohet se a është ky avokat i themeluar në Kosovë. Përfaqësimi i kompanisë në gjykatë nuk paraqet ndonjë arsye se ky avokat duhet konsiderohet së është i themeluar në Kosovë.

Sipas nënparagrafit 1.2 të Nenit 52 personi i obliguar për të paguar TVSH-në është Banka "X". Arsyeja për këtë është se banka është e regjistruar për TVSH. Sa i përket këtij konteksti nuk paraqet ndonjë ndryshim arsyeja se banka është e regjistruar për TVSH sepse ato janë furnizime tjera krahasuar me furnizimet për të cilat ka ofruar shërbim avokati.

Banka X nuk mund të zbres shumën e TVSH si TVSH e zbritshme përveç në rastet kur pranuesi i kredisë është i themeluar jashtë Kosovës, sipas nënparagrafit 3.3 të Nenit 36.

Shembulli 2

Një arkitekt nga Italia është angazhuar nga kompania hoteliere X në Prizren për t'ia skicuar një plan të ri të një ndërtese hoteliere në një vend të caktuar në Prizren. Po ashtu ky arkitekt është angazhuar të mbikëqyrë punën ndërtimore të ndërtesës. Arkitekti qëndron më shumë se 14 javë në Kosovë. Ai qëndron në një dhomë të ofruar nga kompania e hotelit. Kompania hoteliere nuk është e regjistruar për TVSH në Kosovë shkak se qarkullimi i saj ende nuk e ka tejkaluar pragun e 50.000 në një periudhë 12 mujore.

Arkitekti për shërbimet e tij e ngarkon kompaninë hoteliere më një çmim prej 12.000 Euro.

Shpjegoni sesi trajtohet TVSH për shumën e ngarkuar nga arkitekti.

Zgjidhja

Së pari duhet të përcaktohet se a është vendi i furnizimit të shërbimit në Kosovë. Mund të supozohet se kompania hoteliere njihet si person i tatueshëm sipas përkufizimit të veçantë që parashihet nga nënparagrafi 1.1.2 i Nenit 20. Në këtë rast vend i furnizimit të shërbimit është Kosova në pajtim me nënparagrafin 2.1 të Nenit 20.

Gjithashtu, vendi i furnizimit në bazë të nënparagrafit 2.2. të Nenit 20 është Kosova shkak se shërbimet lidhen në një pasuri konkrete që është e paluajtshme. Vlen të përmendet se shërbimet e arkitektit nuk janë të lidhura tek një pasuri specifike e paluajtshme ose një pjese specifike të një pjese të tokës, ato nuk mbulohen nga nënparagrafi 2.2.1 i nenit 20.

Arkitekti nuk mund të konsiderohet se është i themeluar në Kosovë sepse ai do të punoi 14 ditë në një punë specifike nga banesa e tij në Kosovë që i është dhënë në dispozicion si klient.

Pasi që Kompania Hoteliere "X" nuk është e regjistruar për TVSH, arkitekti në pajtim me nënparagrafin 1.1 të Nenit 52 është i obliguar të paguajë TVSH-në. Arkitekti në pajtim me paragrafin 5 të Nenit 6, duhet të regjistrohet për TVSH në Kosovë dhe në pajtim me paragrafin 5 të Nenit 52 duhet të caktojë një përfaqësues tatimor si person përgjegjës për pagesën e TVSH-së.

Shembulli 3

Kompania B nga Maqedonia i ofron këshillime një personi privat se si të fillon një biznes të suksesshëm dhe si t'i fitojë së paku 1 milion Euro në pesë vitet e para si ndërmarrës. Kompania B e ngarkon me një çmim prej 5, 000 Euro për këtë "paketë" shërbimesh që përmban 10 orë takime me një konsulent nga Kompania dhe rekomandime me shkrim të bazuara nga këto takime. Varet nga klienti të vendos se si dhe kur të mbahen këto takime dhe për mënyrën se si kompania duhet t'i kryejë këto rekomandime.

Shpjegoni trajtimin e TVSH-së për çmimin e ngarkuar nga Kompania B

Zgjidhja

Pranuesi nuk mund të njihet si person i tatueshëm sipas përkufizimit të ofruar në nënparagrafin 1.1 të Nenit 20 mbi supozimin se personi ende nuk ka filluar të kryejë shërbime në kapacitetin e personi të tatueshëm sipas nenit 4.

Shërbimet e përmendura nuk mund të kategorizohen si shërbime elektronike siç referohen në Shtojcën 2 të Ligjit.

Sipas nënparagrafit 3.1 të Nenit 20 vendi i furnizimit të shërbimit duhet të jetë vendi ku furnizuesi e ka të themeluar biznesin. Shkaku se nuk ka informata në lidhje me kompaninë Maqedone se a është themeluar në mënyrë fikse në Kosovë apo ngjashëm prej ku është ofruar furnizimi, vendi i furnizimit nuk është Kosova. Rrjedhimisht, Kosova nuk mund të ngarkojë këtë furnizim me TVSH.

Neni 27 Periudha Tatimore

1. Në pajtim me nenin 53, paragrafi 1 i Ligjit, Periudhë tatimore për TVSH do të jetë periudha një muaj kalendarik e cila fillon në ditën e parë të muajit dhe përfundon në ditën e fundit të të njëjtit muaj.

2. Në pajtim me nenin 53, paragrafi 2.1 i Ligjit, për personin i cili për herë të parë bëhet person i tatueshëm në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 i ligjit dhe i cili është regjistruar në pajtim me kërkesat e nenit 7 dhe nenit 8 të Ligjit, Periudhë tatimore për TVSH do të jetë periudha e cila fillon në ditën e regjistrimit për TVSH (që nënkupton datën e momentit kur është kaluar pragu për regjistrim apo kur ka aplikuar për regjistrim vullnetarë) dhe do të përfundojë në ditën e fundit të atij muaji.

3. Në pajtim me nenin 53, paragrafi 2.1 i Ligjit, për personin e tatueshëm i cili dëshiron të çregjistrohet nga TVSH në pajtim me nenin 9 të ligjit, Periudhë tatimore për TVSH do të fillojë në ditën e parë të muajit dhe do të përfundojë në datën e të njëjtit muaj kur është marrë aprovimi i ATK-së për çregjistrim nga TVSH.

4. Në pajtim me nenin 53, paragrafin 3.1 të Ligjit, për personin për të cilin është filluar një procedurë e likuidimit apo bankrotimit për arsye të ndryshme, Periudha Tatimore do të fillojë në ditën kur është bërë hapja e procedurës së likuidimit apo bankrotimit deri në ditën kur do të merret vendimi mbi përfundimin e procedurës së likuidimit apo bankrotimit. Në këto raste, nëse personi i tatueshëm i cili është në procedurë të likuidimit apo bankrotimit, nuk zhvillon aktivitet ekonomik gjatë këtij procesi, nga ky person i tatueshëm do të kërkohej që të dorëzojë një deklaratë deri në ditën e 20 të muajit pas muajit në të cilën është marrë vendimi mbi përfundimin e procedurës së likuidimit apo bankrotimit, pavarësisht se sa zgjat procedura e tillë.

5. Në pajtim me nenin 53, paragrafin 3.2 të Ligjit, për personin për të cilin është filluar një procedurë e likuidimit apo bankrotimit dhe nga Likuiduesi apo kuruesi zhvillohet aktiviteti i biznesit, nga personi i cili është në procedurë likuidimi apo bankrotimi do të kërkohet që të dorëzojë deklaratë të TVSH-së për qdo muaj deri në ditën e 20 të muajit pas muajit për të cilin deklarohet.

Neni 28

Deklarata e TVSH-së, Dorëzimi dhe Pagesa

1. Secili person i tatueshëm, detyrohet që të dorëzojë në ATK deklaratën e TVSH-së deri në ditën e 20 të muajit pas periudhës tatimore për të cilën deklarohet.

2. Nëse dita e 20 do të jetë ditë e shtunë, e diel apo ditë feste zyrtare në Republikën e Kosovës, atëherë dita e fundit për deklarim do të jetë dita e parë e punës pas pushimit apo festës.

3. Deklarata e TVSH-së do të dorëzohet në vendin dhe mënyrën që do të përcaktohet nga ATK, qoftë në mënyrë fizike apo elektronike.

4. Forma e deklaratës si dhe informatat që do të përmbajë kjo deklaratë, do të përcaktohen nga ATK si dhe personit të tatueshëm do ti ofrohet një udhëzim që përshkruan në mënyrë të veçanta për të gjitha zërat që duhet të plotësohen.

5. Secili person i tatueshëm deri me ditën 20 të muajit pas periudhës duhet të dorëzojë deklaratën tatimore TVSh dhe nëse periudha është për pagesë duhet të paguhet deri në këtë ditë ,çdo vonesë e pagese do të ndëshkohet sipas legjislacionit tatimore të ATK.

Neni 29

Mbajtja dhe Ruajtja e Librave të TVSH-se Shënimet dhe Dokumentacionet tjera

1. *Libri i blerjeve*

1.1. Libri i blerjeve është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm.. Ai duhet të tregojë në faqen e parë numrin e identifikimit dhe emrin e personit. Të gjitha faqet duhet të kenë numër rendor. Libri plotësohet çdo ditë nese ka transaksione. Në të regjistrohen për çdo transaksion furnizimi dhe të dhënat e faturës që paraqet transaksionin .

1.2. Në këtë libër regjistrohet data e lëshimit të faturës, numri rendor i faturës, të dhënat e deklaratës së importit (nr i DUD),emri i shitësit dhe numri i identifikimit tatimor të tij.

1.3. Blerjet regjistrohen në vlerë totale e cila përfshin edhe TVSH (nëqoftëse ka) si dhe të ndara në blerje me TVSH dhe në blerje pa TVSH. Blerjet me TVSH regjistrohen të ndara në importe dhe blerje brenda vendit.

1.4. Për çdo blerje me TVSH personi regjistron vlerën e tatueshme dhe TVSH që i korespondon kësaj blerje.

2. *Libri i shitjeve*

2.1. Libri i shitjeve është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm.

Ai duhet të tregojë në faqen e librit numrin e identifikimit dhe emrin e personit të tatueshëm. Të gjitha faqet duhet të kenë numër rendor. Libri plotësohet çdo ditë nese ka transaksione. Në të regjistrohen për çdo transaksion klienti dhe të dhënat e faturës që paraqet transaksionin.

2.2. Në librin e shitjeve regjistrohen data e lëshimit të faturës, numri rendor i faturës, dhe data e numri i deklaratës doganore kur mallrat eksportohen (nr i DUD), emri i klientit dhe numri i identifikimit të tij.

2.3. Në të regjistrohet vlera totale e transaksionit përfshire TVSH (nëqoftëse ka).

2.4. Shitjet regjistrohen të ndara në të përjashtuara, shitjet me te drejt kreditimi,eksportet dhe shitjet e tatueshme.


2.5. Për çdo shitje të tatueshme regjistrohen vlera e tatueshme dhe TVSH.

2.6.Periudha e ruajtës për librat dhe regjistrimet dhe dokumentet e tjera origjinale të jetë gjashte vjet, ashtu siq eshte paraparë me legjislacionin tatimore te ATK-se.

Neni 30 **Hyrja në Fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave.

Bedri HAMZA



Zv. Ministër

Datë, 30.07.2010